

30 MARS, 2024

HEJZA

NEHAS SOPAJ, shkrimtar

***VETVETES IA BËJMË VALLEN
E DJALLIT!***

hejza.com

Zona e eklipsuar

EKSTRAKTI POLITIK I MELANKOLISË SË BUKUR

Qëllimi i sajimit të rezervateve e të getove të para shprehte një diferencim nga e shëmtuara, nga e sëmura, nga e ashpra dhe, në të tilla kushte, shoqëria ndahej në "pushtet i natyrshëm" dhe "të pushtuar të natyrshëm"! Më vonë, kur do të kërkohet Zoti i çdo gjëje, pra edhe ai, Zot i Natyrës, do të nisë revolta, rebelimi e revolucionet kundër sajimit, gënjeshtërisë e manipulimit

Nga Avni HALIMI

Dekadave të para të shekullit shtatëmbëdhjetë, krijuesit, artistët dhe shtresat e tjera që e përbënin elitën e një kombi, në disa shtete perëndimore kishin promovuar heqjen dorë nga Zoti, nga ajo qenie e padukshme. Pra, nuk e kishin flakur besimin, por kishin hequr dorë nga të besuarit në mrekullitë e Zotit misterioz. Besimin e vet e kishin orientuar në Natyrë. Koncepti i të besuarit të tyre mbështetej në mrekullitë dhe në fenomenet e ndryshme natyrore. Natyra ishte ajo që krijonte dhe që kishte fuqinë e shkatërrimit të çdo gjëje. Logjikisht, edhe lutjet, përgjërimet e faljet i dedikoheshin vetëm natyrës. Çdo gjë funksiononte në raport me natyrën. Krijonin për natyrën ndërsa në krijimtarinë e tyre zinte vend vetëm natyra. Në tërë atë korpus ndjenjash e shqetësimesh që i posedon njeriu filloi të mbisundojë dhembja. Njerëzit nisën ta kultivojnë dhembshurinë. Kësaj i thanë "Melankolia e bukur"! Të cytur nga kjo ndjenjë u ngrit tradita e përkujdesit ndaj të shenjtës natyrë, përkujdesit ky që manifestohet përmes krijimit të pamjeve sa më idilike natyrore, të peizazheve të gjalla. Do të zë fill kultura e ngritjes së parqeve në oborre të shtëpive, në oborre të vilave mbretërore, ndërkohë që, stili barok i arkitekturës do të mëtojë të jetë në harmoni të plotë me këto peizazhe të bukura të kopshteve e të parqeve. Pra, truri dhe dora e njeriut do të vihet në funksion të madhërimtë asaj që fal natyra. "Natyra falë, Natyrës i falemi", ishte motoja e shtresave elitiste të asokohshme. Këtë ndjenjë natyraliste e hasim si në art, në letërsi, në muzikë, në arkitekturë etj. Për dy shekuj rresht dominoi "Melankolia e bukur", derisa nuk u këndellën dhe nuk vërejtën se ky angazhim shpirtëror po krijonte edhe shtresën tjetër të shoqërisë, shtresën neverike, shtresën rebele që po rebelohej jo vetëm kundër natyrës, por edhe kundër pushtetit që po e madheronte natyrën. Natyra për dikë ishte nënë e për dikë njerë dhe, në harmoni me këtë ligj natyror, po funksiononte edhe pushteti. Natyra falte molla të shëndosha e të krumbura. Mollët e mira viheshin me kujdes nëpër arka e sëndukë, ndërsa të krimbat hidheshin në pleh, në ndonjë vend të shkretë. Konform këtij ligji natyror, raca e shëndoshë dhe e bukur rehatohej nëpër palate e oborre, ndërsa të shëmtuarit, të sëmurit e ata të krahut të punës sistë moheshin periferive, në krahun tjetër të bregut, të përroit, të lumit. Pra, po formësohej racizmi ndërkohë që këtu



diku zënë rrënjë rezervatet e getot që u trashëguan deri më ditët e sotshme. Por, ka dallim në qëllime. Qëllimi i sajimit të rezervateve e të getove të para shprehte një diferencim nga e shëmtuara, nga e sëmura, nga e ashpra dhe, në të tilla kushte, shoqëria ndahej në "pushtet i natyrshëm" dhe "të pushtuar të natyrshëm"! Më vonë, kur do të kërkohet Zoti i çdo gjëje, pra edhe ai, Zot i Natyrës, do të nisë revolta, rebelimi e revolucionet kundër sajimit, gënjeshtërisë e manipulimit. Atëherë shpëtimi do të kërkohet në atë Zot i cili do të jetë i të gjithëve, në atë Zot para të cilit do të përulen të gjithë, edhe njeriu edhe druri, edhe guri e uji! Gjurmët e këtij manipulimi, gjurmët e këtij truku politik nuk u çrrënjësën kurrë. Manipulimi në emër të "bukurisë natyrore" nuk pushoi as sot e kësaj dite. Tani, "bukuritë natyrore" përdoren si mjet përkufizues që e definojnë një realitet. Është fajtor Vardari (si mjet natyror) që në mënyrë kaq të trishtë e ka mundësuar ndarjen e Shkupit. Apo, fajtor janë varrezat e Kajros që janë populluar prej më së paku dy milion njerëzve "problematikë". Është fajtor mali që lejon të na zhdërgjehen në qytet malokë e analfabetë, "njerëz të pagdhundur". Pra, "elementet natyrore" në këto raste përdoren sa për ta spostuar fajin të një "fajtor" që është pa baba e pa nënë. Nëse dikur shtresimet e shoqërisë për piramidale që sajoheshin përmes mi-

vratimeve të detyrueshëm "të fakteve" se është vullnet i Natyrës që shtresat e poshtme t'i mbajë sa më afër ferrit, ndërsa të lartat më afër Zotit e parasjës, sot, këto shtresime, duke e ruajtur këtë simbolikë, fund e krye përdoren për qëllime politike. Natyrisht, në shtetet komb, këto shtresime krijohen për shkak të problemeve sociale. Dhe atje dallojnë punët në krahasim me shtresimet sociale në shoqëritë multietnike. Pse njëra anë që shtrihet në të djathtë të Lumit Vardar lulëzon, ndërsa ana e krahut të majtë ka pamje të trishtueshme! Për Shkupin fotografitë e hershme flasin se ky qytet shtrihet në të majtë të Vardarit, ndërsa faktografitë flasin se, deri në vitet tetëdhjeta ky qytet ishte kryeqyteti me më shumë shqiptarë në botë. Tërmeti i vitit 1963, si fatkeqësi natyrore, pa dyshim që e përshpejtoi një projekt që synonte ngritjen e një qyteti të ri, gjithnjë duke u përkujdesur që të ruhen gërmadhat e qytetit të shkatërruar nga tërmeti. Dhembje për qytetin e dërmuar dhembje për popullatën e raskapitur! Nën politikën e kësaj dhembje do të nis realizimi i projekteve nacionale të strukturave maqedonase komuniste. Dhe ky projekt do të realizohet deri në ditën e sotshme dhe, me gjasë që të vazhdojë deri në kiamet. Të gjitha ndërtimet, të gjitha objektet e rëndësishme shoqërore, të gjitha qendrat rekreative, sportive, shëndetësore e tregtare - të gjitha këto do të ndërtohen në të djathtë të Vardarit.

Shteti shpreh mirësinë edhe për anën e mëngjër të Vardarit! Edhe aty mund të ndërtohet, madje pareshtur. Natyrisht, prapavija politike është shumë e qartë. Sikur të mos ishte projekt nacional maqedonas, a do të kishim sot një lagje si Gazi Baba! A do të kishim një lagje si Serava me pamje të paralagjeve pakistaneze; a do të kishim një lagje Dizhon apo një lagje Viz Beg që me zhargonin përçmues quhen "pyje të pashkelura të xhunglës urbane"! Pra, sot këta "pyje" janë të pashkelura edhe për organet kompetente të rendit e të sigurisë. Nëpër këto lagje mund të shkelin vetëm shqiptarët dhe, meqë organet e rendit, të kontrollit e të sigurisë nuk mund të kenë akses të lehtë aty, kjo apriori do të thotë se aty lulëzon nëntoka kriminele. Pra, ky është synimi i "shpirtngushtësisë" së një populli shumicë që mëton të vë monopol mbi të mirat që dalin nga të pasurit shtet. Në rrethana multietnike gjithnjë zhvillohen garat politike të eliminimeve etnike. Etnia shumicë pos që investon për të mirën e vet, po aq më tepër investon për degradimin, deklasimin dhe në eliminimin e etnisë tjetër konkurrenente. Investimet e huaja, kapitali shtetëror dhe pasuria e një shteti duhet të koncentrohen vetëm në anën e sigurtë, në zonën urbane, në krahun "përtej amazonian" që është larg "xhunglës urbane" dhe banorëve të egër të asaj xhungle! Kjo është një nga më shumë të vërtetat që flasin për atë se pse një krah të Shkupit, atë ku banojnë shqiptarët, sot e kemi si metaforë të mjerrimit urban, të primitivizmit klanor e të "padëgjueshmërisë malokiane". E aty bëhet jetë, e aty jetojnë njerëz fisnik, bujarë e të ndërgjegjshëm për atë se, në këtë krah të Lumit Vardar, është mbledhur aq shumë llum sa vetëm ndonjë tërmet fatal në i shpëtoftë nga ngulfatja e egër urbane. Në këto "zona të errëta" ëndërrohet edhe për këtë lloj tërmeti, veçse ëndërruesit janë të ndarë më dysh: njëra palë ëndërron se si bie tërmeti mbi këto lagje duke ua shkurtuar problemet dhe hallet e përditshme, ndërsa pala tjetër ëndërron se si tërmeti bie në pjesën e urbanizuar të Shkupit, duke i eliminuar divergjencat sociale e urbane të të njëjtit qytet. Ekziston vetëm një dallim: divergjencat mund të zyrtarizohen, të përkrahen dhe të avancohen, ndërsa ëndërrat duhet të ngulfaten dhe rreptësisht ndalohet rrefimi i tyre. Po u rrëfyn, vjen ujku e ta ha gjumin!

Problemet që (nuk) shqetësojnë

NEVOJË PËR TEKSTE TË REJA SHKOLLORE

Tekstet nuk ofrojnë dije që t'i aftësojnë nxënësit të analizojnë e gjykojnë në bazë të mendimit kritik, por ua kufizojnë aftësinë për të analizuar dhe për t'u shprehur

Dr. Antela VOULIS

Pas një hulumtimi të bërë mbi tekstet e gjuhës shqipe na ka rezultuar se këto tekste kanë problematika serioze metodologjike dhe shkencore, që ua bëjnë të pamundur nxënësve marrjen e njohurive të duhura gjuhësore, apo më keq akoma, po ua bëjnë mësimin e gjuhës shqipe një mision të pamundur, një luftë të përditshme. Dhe cila lëndë mund të mësohet me dëshirë kur tekstet janë kaq të papërshtatshëm e, si rrjedhim, tejet të padëshirueshëm për nxënësit? Pikësepari kemi konstatuar se në pjesët letrare të publikuara në faqet e këtyre teksteve, nuk janë përfaqësueset më të mira të letërsisë shqiptare dhe botërore. Në to përfaqësohet shumë dobët letërsia shqipe. Mungojnë emra të njohur autorësh të letërsisë shqipe. Mungon Eposi i Kreshnikëve, kjo pasuri e madhe kombëtare. Nëpër faqet e këtyre teksteve ka shumë legjenda e mite filipineze, kineze dhe indiane. Diku nxënësit mësojnë për zanat, por, fatkeqësisht, ata mësojnë për to në një legjendë indiane. Në këto tekste nuk ka tregime, ka shumë përralla, pak vjersha, më së shumti të autorëve të panjohur, ose të personave që nuk janë fare shkrimtarë, por me siguri të njohur dhe miq të autorëve të teksteve, ose pjesë letrare me shumicë të vetë autorëve të teksteve, të cilët nuk janë shkrimtarë. Edhe autorët e huaj të përzgjedhur nuk janë përfaqësuesit e letërsisë botërore, por janë emra krejtësisht të panjohur. Pjesët letrare të përzgjedhura nuk janë të përshtatshme për moshën e nxënësve. Pjesët letrare të autorëve të huaj janë të përkthyer shumë dobët dhe në to mungon emri i përkthyesit. Si pjesët e autorëve të huaj, si ato të autorëve shqiptarë janë me tematika shumë të varfra për kontekstin e sotëm të formimit të nxënësve. Këto pjesë letrare të përzgjedhura për t'u publikuar në librat e gjuhës nuk nxisin të lexuarin, nuk kanë kuptim, nuk kanë me-

szazhe dhe kanë moral të dobët. Në këto tekste nuk trajtohet asnjë figurë letrare. Nuk ka analiza letrare, stilistike dhe artistike dhe as analiza të tekstit dhe zhvillimit të mendimit kritik. Nuk ofrojnë dije që t'i aftësojnë nxënësit të analizojnë e gjykojnë në bazë të mendimit kritik, por ua kufizojnë nxënësve aftësinë për të analizuar dhe për t'u shprehur. Analizat janë të llojit: A të pëlqeu kjo poezi? Shkruajji vargjet që të pëlqejnë. Thuaj pse? Ose: Numëroni strofat dhe vargjet e çdo strofe. Ka kërkesa të çuditshme për nxënësit, të tilla si: Shkruaj një poezi. Kërkesë që dëshmon se autorët e teksteve nuk e dinë se poezinë nuk mund ta shkruajë kushdo, aq më pak nxënësit e shkollës fillore. Tekstet nuk ofrojnë dije që t'i aftësojnë nxënësit të analizojnë e gjykojnë në bazë të mendimit kritik, por ua kufizojnë aftësinë për të analizuar dhe për t'u shprehur. Ato nuk përfaqësojnë faza dhe periudha të zhvillimit të letërsisë së vjetër dhe bashkëkohore. Ato nuk ndikojnë në thellimin e mendimit dhe nuk nxitin fantazinë. Njohuritë mbi gjuhën janë të renditura në një mënyrë të paqartë, të pasaktë, të rrëmujshme, të cunguar. Përgjithësisht mungojnë konceptet, në vend të koncepteve gjuhësore përdoren ngjyrat (fjalët me ngjyrë të gjelbër janë mbiemra, fjalët me ngjyrë të kuqe janë folje), sikur të ishte lëndë e artit pamor dhe jo gjuha shqipe. Edhe kur aty-këtu jepet ndonjë koncept gjuhësor, ai është gjysmak, jo i formuluar siç duhet, shpesh i njëjtë sime konceptin e dhënë në tekstin e klasës paraardhëse apo pasardhëse. Nga viti në vit nuk shtohet asgjë më shumë mbi njohuritë e mëparshme. Shpesh përsëriten të njëjtat njohuri nga viti në vit, aq sa është vështirë të bësh dallimin midis tekstit Gjuha Shqipe 2 me tekstin Gjuha Shqipe 3, 4 ose 5. Këto tekste japin pothuajse të njëjtin nivel dijes, gjithmonë të cunguar, të njëjtat përralla e legjenda (indiane, filipineze, kineze), të njëjtat analiza letrare me numërim vargjesh e strofash poezish.

Herë-herë jepet pak informacion për shkrimtarë shqiptarë a të huaj e herë të tjera aspak informacion, por ndodh që ndonjë shkrimtari t'i jepet hapësirë edhe një apo dy faqe libri. Në to mungojnë informacione për tradita e festa shqiptare tradicionale, dhe u kushtohen deri në disa faqe libri festive të huaja, si Hallouini. Emrat e fëmijëve të përdorur nëpër fjalë e ushtrime janë emra jopërfaqësues të identitetit kombëtar, si Klesti, kur do duhej të kishim emra që përfaqësojnë identitetin kombëtar, si Genti, Enkeli, Teuta etj. Në këto tekste shihet një përpjekje për të dhënë informacione të panevojshme për zoologjinë apo shkencën të tjera, për vende të largëta të botës, krejt pa lidhje me gjuhën e letërsinë, pa lidhje me programin mësimor. Vihet re përdorimi i fjalëve të çuditshme të vetë autorëve të teksteve, si "kostumier" (kur në shqipe themi kostumograf), ujkosh (kur në shqipe themi këlysh ujk) etj., Fjalët e reja nuk shpjegohen siç duhet, ato shpjegohen pjesërisht ose në vend të shpjegimit të fjalëve në libër jepet fotografia e objektit dhe u lihet nxënësve që ta marrin me mend dhe ta shpjegojnë me fjalë se çfarë është objekti i dhënë në figurë. Gabimet drejtshkrimore janë gjithashtu të panumërta, aq sa është e vështirë të besosh se përveç katër autorëve me këta tekste kanë punuar edhe disa redaktorë e korrektorë. Në programin mësimor të gjuhës shqipe pretendohet që me anë të këtyre teksteve nxënësit do zhvillojnë të lexuarin, të folurin dhe të shkruarun, si dhe do rrisin njohuritë gramatikore e gjuhësore, por realisht nuk ka sesi të ndodhë një mrekulli e tillë, sepse këto tekste janë një kakofoni marramendëse, që i çorientojnë dhe i lodhin fëmijët dhe si rezultat e bëjnë mësimin e gjuhës aspak të dashur e tërheqës për ta, për të mos thënë të urryer. Vargu i problemeve të teksteve të gjuhës shqipe në Shqipëri është edhe më i gjatë sa e përshkruam më lart dhe për këto problem do nevojiteshin studime e libra

studimorë, që duan vite pune. Megjithatë, shkurt ose gjatë, e vërteta e hidhur është se tekstet shkollore ekzistuese nuk i formojnë gjuhësisht dhe letrarisht nxënësit. Përkundrazi, këta libra i kanë larguar ata prej vitesh nga gjuha shqipe. E kundërta ndodh me mësimin prej tyre të gjuhëve të huaja. Nxënësit katranjosë në gjuhën shqipe dalin shkëlqyer në anglisht a në gjuhë të tjera. Si ka mundësi një gjë e tillë? Përgjigjja është e qartë, në ditët e sotme fëmijët janë të orientuar drejt gjuhëve të huaja për shkak të nxitjes së prindërve me qëllim emigracionin ose me qëllim punësimin e tyre në të ardhmen në kompani ku nevojitet gjuha e huaj, prandaj dhe nevoja e mësimin të gjuhëve të huaja i bën ata ta lënë pasdore shqipen. Sigurisht që është edhe kjo. Megjithatë, jo plotësisht. Kushdo që i ka parë tekstet e gjuhëve të huaja që mësohen në shkollë ose në qendra kursesh me siguri që ka vërejtur se, në ndryshim nga tekstet e gjuhës shqipe, ato janë të përgatitura disi apo shumë ndryshe, janë organizuar bukur mirë, me standarde të tjera gjuhësore, shkencore e didaktike. Kaq thjeshtë! Shqipja jonë është shumë e bukur dhe e dashurueshme siç është, por fatkeqësisht deri tani është keqtrajtuar dhe keqprezantuar në tekstet shkollore nga hartuesit e tyre, shumica çirakë të paditur dhe të paaftë. Prandaj shqipja ka nevojë urgjente për tekste të reja, që t'ia nxjerrin asaj vlerat dhe bukurinë e mohuar në tekstet shkollore të deritanishme, të hartuara keq dhe shëmtuar. Tekstet e reja për gjuhën shqipe duhet t'i bëjnë vetëm institucionet e duhura shtetërore (si dikur), me gjuhëtarë të mirëfilltë, me metodologjistë dhe specialistë të duhur, por kurrsesi jo me pseudogjuhëtarë pazarxhinj të shqipes, jo më shtëpitë botuese, të cilëve nuk u interesojnë vlerat dhe bukuria e shqipes, por vetëm fitimet me tekstet shkollore!



Sfidë e kohës

DEGRADIMI I VLERAVE LETRARE

Tabloja aktuale e realitetit tonë letrar duket dëshpëruese, me perspektiva të pakta për një rikthim në rrjedhat normale që do të shënonin hapa progresivë

Zyrafete SHALA

Erozioni i vlerave letrare në mjedisin tonë duket se tani ka tejkaluar kufijtë e një shqetësimi thjesht intelektual, për të evoluuar në një vuajtje serioze që gjithnjë e më tepër po varfëron aftësinë tonë kolektive për të bërë dallimin e asaj që është vlerë estetike, nga ajo që pretendon të ofrohet si e tillë. Në sfondin e fjalëve të shkruara me nxitim dhe mendimeve të pa artikuluara deri në fund, na shfaqet një shoqëri e dashuruar në aktin e të shkruarit, por mjerisht tejet indiferente ndaj esencës së mjeshtërisë së vërtetë letrare. Shpërfillja e shenjtërisë së fjalës së shkruar dhe mungesa e përgjegjësisë ndaj aktit të krijimit, që ka rezultuar me vërshimin enorm të botimeve, duket se ka goditur rëndë në veçanti poezinë, edhe pse nuk mund të thuhet se kanë shpëtuar lehtë as zhanret e tjera. Poezia, ajo që dikur konsiderohej akt sublim i eksplorimit të guximshëm të thellësive të qenies dhe botës, ajo që Lasgushi e njihje si angazhim të shpirttrave të lartë, tani po nëpërkëmbet nga turmat e fiksuara në arritjen e kënaqësisë e menjëhershme, që po e përdorin atë si mjet për arritjen e famës kalimtare. Akti krijues, si një nga mënyrat e përfshirjes në thellësinë dhe kompleksitetin e nuancave të jetës, ka intriguar për kërkim të mëtejshme filozofët, psikologët, studiuesit e fushave të ndryshme, por edhe vetë poetët, mendimet e të cilëve kanë përvijuar kornizën teorike të poezisë si krijim. Reflektimet e mendjeve të urta që përgjatë shekujve i janë qasur krijimit si njërit prej angazhimeve më fisnike të *homo sapiensit*, në kakofoninë e përditshme që na servohet si art, ndonjëherë krijojnë përshtypjen e zërave që vijnë nga një univers tjetër. Aristoteli e konsideroi poezinë si një imitim të realitetit, duke u fokusuar në paraqitjen e veprimeve dhe emocioneve njerëzore. Ai theksoi përdorimin e gjuhës, ritmit dhe harmonisë në poezi. Ndërkohë që Horaci theksoi qëllimin e dyfishtë të poezisë – *dulce et utile*, duke besuar në fuqinë e poezisë në argëtim dhe edukim; pra ndërthurjes së kënaqë-

sisë estetike me elemente etike e didaktike. Duke i cilësuar poetët si ligjvënës të panjohur të botës, Percy Shelley në esenë *A Defense of Poetry*, e paraqet poezinë si një forcë për ndryshime shoqërore dhe politike, të aftë për të ngritur shpirtin njerëzor. Më tej Wordsworthi besonte se poezia duhej të lindte nga vërshimi spontan i ndjenjave të fuqishme dhe të pasqyronte lidhjen e poetit me natyrën. T.S.Elioti në esenë e tij *Tradita dhe Talenti Individual*, diskutoi konceptin e *korrelativit* objektiv apo përcjelljen e emocioneve përmes simboleve të jashtme, konkrete. Dhe së fundi, mbase duhet ndalur te mendimi i Rainer Maria Rilkes që krijimin e poezisë e paraqet si ekuivalent të të jetuarit, apo, thënë në mënyrë më të qartë, sipas Rilkes kushdo që mund të jetoj pa shkruar poezi, duhet të heq dorë nga ajo, për t'ua lënë poezinë atyre që nuk mund të frymojnë dot pa shkruar. Mirëpo, mënyra se si po trajtohet sot te ne, jo vetëm që e zhvesh poezinë nga aureola e magjisë që e ka mbështjellë atë ndër shekuj, por edhe e zbrit në terrenin e vulgaritetit të përditshëm dhe e bën pasqyrë të degradimit intelektual dhe cektësisë emocionale. Prirjen për nëpërkëmbjen e vlerave dhe guximin e shfrenuar për të bërë karrierë në terrene të panjohura i ka identifikuar qysh herët Fishta, madje edhe ka ironizuar me to: *Due me thënë, se për ç'do zanat, qi do me kap nieri, duhet një farë përgatitje gjithkund (...). Vetëm është një zanat, qi në Shqipëri s'lypë kurrfarë përgatitje: letërsija!* Është e vështirë të thuhet se në çfarë niveli ishte asokohe, por aktualisht, kjo dukuri duket se ka arritur kulmet e saj. Me qenë se letërsia përfaqëson vlerat e trashëguara nga njëri brez tek tjetri, thellësinë kulturore, historinë, shpirtin krijues të një populli dhe identitetin e tij, atëherë është e domosdoshme, për të mos thënë emergjente, një qasje serioze ndaj saj. Kjo përgjegjësi bie në radhë të parë mbi profesionistët dhe institucionet kompetente, por edhe mbi këdo që i konsideron si të shtrenjta këto vlera. Me këtë nuk duhet nënkuptuar në asnjë mënyrë kufizimin e lirisë së krijimit apo botimit,

por angazhimin kolektiv për të nxitur krijimin e një mjedisi letrar që ofron mundësinë e ngritjes së shijes estetike të lexuesve, por edhe kultivimin e përgjegjësisë ndaj fjalës së shkruar dhe përgjegjësisë në dhënien e vlerësimeve. Tabloja aktuale e realitetit tonë letrar duket dëshpëruese, me perspektiva të pakta për një rikthim në rrjedhat normale që do të shënonin hapa progresivë. Përtej sferës individuale të autorëve, një sërë fraksionesh letrare dhe platformash digjitale përkrahin dhe lartësojnë me këmbëngulje vargjet boshe, të cilat më shumë i ngjajnë një pingu figurash stilistike pa funksion, sesa një kompozimi të mirëfilltë poetik. Fatkeqësisht, këto të ashtuquajtura 'krijime' vazhdojnë të lartësohen në mënyrë të paarsyeshme, jo vetëm nga ata që kanë njohuri të kufizuara në sferën e letërsisë, por, në mënyrë alarmante, edhe nga profesionistët e fushës. Arsyet që i motivojnë këta të fundit për të zbritur në nivele të tilla dëshpëruese mund të jenë, sa të ndryshme, aq edhe të parëndësishme, megjithatë, mungesa e përgjegjësisë për dëmin që vlerësimet e tyre i shkaktojnë letërsisë, mbetet një çështje që kërkon sqarim. Inkurajimi i pseudovlerave bart në vete rrezikimin e integritetit të standardeve letrare në përgjithësi, ndërsa devijimet e tilla të mbështjella me petkun mashtrues përbëjnë një kërcënim të vërtetë për thelbin dhe vitalitetin e trashëgimisë sonë letrare. Për më tepër, më shumë se mbi ata që duan të njihen si poetë, përgjegjësia për këtë bie mbi ata profesionistë që koketojnë me pseudokrijuesit, ngase kompetenca profesionale duhet të jetë mburojë kundër gërryerjes së vlerave letrare, e jo të kontribuojë në zhdukjen e tyre. Nëse vlerësimi i drejtë nuk është lehtë të shpallet në situata të veçanta, atëherë, indiferenca dhe heshtja, ndonëse nuk ofrojnë zgjidhje, mund të jenë më të preferueshme sesa bashkëfajësia në zhvlerësimin e standardeve letrare dhe përvetësimi i një kulture lavdërimi të pasinqertë. Kritika konstruktive, e ofruar me takt dhe respekt, është një kontribut shumë më i vlefshëm për komu-

nitetin letrar sesa vërshimi pa kriter i lavdërimeve. Pasojat që sjell ngurrimi në dhënien e vlerësimeve të ndershme brenda sferës së poezisë shtrihen përtej veprave apo poetëve individualë; ato shtrijnë hijen mbi tërë peizazhin e vlerësimit letrar. Ndërsa mbivlerësimi i shfrenuar që një profesionist u bën krijimeve pa ose me vlera të dyshimta, në njërin anë krijon një cikël mediokriteti, që nxit shumimin e shkrimeve të cekëta dhe pa fuqinë transformuese që zotëron poezia e vërtetë, ndërsa në anën tjetër inkurajon një armatë të tërë të 'poetëve' të vetëshpallur, që të insistojnë në rrugën e nisur, por edhe e redukton poezinë në një mall të thjeshtë, mall që kërkon aprovimin e masave përmes popullaritetit dhe jo përmes vlerës estetike letrare. Së fundi, ajo që është më e rëndësishme, e tërë kjo dinamikë të rinjve që sapo kanë filluar të hapërojnë në botën e poezisë, jo vetëm u jep shembullin më të keq, por edhe i bën konfuzë në identifikimin e vlerave, duke u imponuar krijime mediokre në vend të arritjeve të vërteta letrare. Refuzimi për t'iu bashkuar rrjedhës, në këtë rast, nënkupton aprovimin e kulturës progresive dhe bojkotimin e garës për t'iu lartësuar, duke shkelur mbi vlerat letrare e artistike që po japin shpirt nën gërmadhat e kulturës kombëtare. Koha do të tregojë se nga ajo mori emrash që sot pretendojnë se i bëjnë nder letërsisë shqipe, do të jenë të pakët ata që me veprat e tyre do të arrijnë të komunikojnë me brezat, sepse jo çdo brez do të ketë lexues me shije të varfër estetike. Degradimi i vlerave letrare është një sfidë që kërkon introspeksion kolektiv dhe një angazhim të ripërtërirë për të ushqyer një kulturë që nderon fjalën e shkruar. Është koha që të heqim dorë nga insistimi për të përmëshur egot narcistike, të angazhohemi në ngritjen e shijes estetike, të mos i vëmë në lojë vlerat e trashëguara letrare dhe ta kuptojmë se letërsia nuk është thjesht pasqyrim i identitetit kulturor, por është forcë udhëzuese që ka potencialin të formësojë ndërgjegjen tonë kolektive dhe të ndikojë në drejtimin e përparimit shoqëror.



Midis nesh

PLAGJIATURA, SIMPTOMË E NJË EPIDEMIE TË RËNDË

Si do të shpëtojmë nga plagjiatura, nga pseudo-poetët, pseudo-shkrimtarët, ata që na vjedhin artin dhe shpirtin, ata që po na e shterin fare dhe dëshirën për t'u marrë me të? Po kritikët! Akademikët! Lidhja e shkrimtarëve!

Armenida QYQJA

Tashmë është shkruar kaq shumë për plagjiaturën në qarqet e shkrimtarëve dhe poetëve, sa jam e bindur që shumë lexues as do të marrin mundimin të ndalen e të lexojnë këto pak rreshta. Vërtetë që shkas për këtë shkrim u bë një plagjiaturë e rëndomtë që iu bë një prej poezive të mia, por dëmi i plagjiaturës, që është bërë një shfaqje epidemike, është shumë më i thellë sesa përmasat e artit dhe artistit. Kjo është çfarë ne nuk po arrijmë të kuptojmë dhe jemi bërë si mjek-pacientët komercial në kërkim të një recete farmaceutike, që ne e dimë shumë mirë që vetëm sa i trajton simptomat, por nuk i shëron ato. "Hajdutët! Kapini hajdutët!", vetëms'e nuk bëhet fjalë për "paratë e dashura", por për poezitë, librat. Kush, si do ta shpëtojme artin? Si do të shpëtojmë nga plagjiatura, nga pseudo-poetët, pseudo-shkrimtarët, ata që na vjedhin artin dhe shpirtin, ata që po

na e shterin fare dhe dëshirën për t'u marrë me të? Kritikët! Akademikët! Lidhja e shkrimtarëve! Bla-bla-blaaaaa... Me falni, por apo e dëgjon ndonjëri nga jush Molierin që shqyhet gazit atje lart në parajsë?! 1670. Viti kur ai shkroi "Borgjezin fisnik". S'do t'ju marr shumë kohë me analiza, do t'ju kujtoj vetëm se ky borgjezi i etur për të qenë në të njëjtin rang me fisnikët, u mundua të blejë tituj, mori dhe mësues vallëzimi, muzike, filozof. Të tërë e rropën të gjallë duke ia mbishitur vlerat e artit të tyre, ndërkohë që ai ishte krejt i paaftë për to. Mësuesi i filozofisë e nisi me Logjikën dhe Moralën, por këto nuk na i pëlqyen tregtarit. Tabloja është e njëjtë me përjashtim të veshjeve dhe parukeve. Shoqërisë sonë nuk i pëlqejnë as Logjika e as Morali. Boshllëku shpirtëror dhe injoranca kanë futur në rrjetin e tyre një pjesë të mirë të shoqërisë shqiptare. Më shumë se 800 poet në një konkurs! E ku, në një shoqëri ku çdo ditë po përdhunohen

fëmijë nga të afërm, po dhunohen gra e pleq, po vetë-helmon vajza në lule te moshës me fotoksininë që shitet farmacive...A duhet të vazhdoj? Po ku është kjo shoqëria jonë kaq e ndritur sa të ketë 800 poet aktivë? Ju them unë se çfarë ka kjo shoqëria jonë albanistane: ka shumë fukarallëk material dhe shpirtëror, njerëz që jetojnë pa bukë dhe njerëz që nuk dinë ç't'i bëjnë paratë dhe blejnë ndjekës në instagram, njerëz që blejnë diploma e paguajnë redaktorë t'ua ndreqin broçkullat dhe botojnë libra, njerëz që vjedhin dhe manipulojnë artin e të tjerëve vetëm të fryhen dhe ata. Por, ne fakt harrojnë ose nuk dinë shumë gjëra. Harrojnë që ata nuk dinë as A-në, as shkrim e këndim dhe pastaj vijnë të thonë si fisniku i Molierit, "kam dyzet vjet që flas në prozë!" Është shumë e thellë dhe aspak për të qeshur se këta individë janë dhe mësues e zyrtarë në poste administrative. Çfarë shembulli japin dhe çfarë vlerash përçojnë te

nxënësit apo vartësit e tyre? Themë pastaj pse nuk bëhet Shqipëria?! Si do të bëhet?! Kush do e bëjë?! Antivlerat që fitojnë mbi vlerat?! Njerëzit që i kanë blerë postet drejtuese, diplomat?! Këta të 800-tët?! Të më fal pakica e nderuar që padashur ka hyrë aty, në atë kazan. Konkluzioni? Si do shpëtojmë nga kjo epidemi? Nuk e di, por di një gjë që nga vegjëlja: dezinfektimi me gëlqere, hedhja apo djegia e disa sendeve si jorgan, batanije etj...Mos u shqetësoni! Nuk kam luajtur mendsh të vë njerëz në turrat e druve! Zot na ruaj! Por, duhen demaskuar rastet me prova të qarta, konkrete. Duhet ndëshkuar nëse ata janë në disa poste kyçe si arsim, kulturë. Duhet hequr plagjiaturat nga libraritë apo rrjetet që mund të kontrollohen. Duhet të gjobiten plagjiaturistët dhe bashkëpunëtorët (redaktorët, shtëpitë botuese). Po nuk u morën ca masa e po nuk u dhanë ca ndëshkime, ne do vazhdojmë të mbetemi në këtë rreth vicioz.

Abetarja shqiptare

NJË RRUGË E VËSHTIRË

Qysh nga abetarja e parë e Veqilharxhit që paralajmëroi lindjen e një periudhe të re në historinë e shqipes, Rilindjes sonë, rruga drejt emancipimit dhe afirmimit të gjuhës shqipe është një proces i gjatë dhe i mundimshëm, por që ka dhënë fryte të çmuara për popullin shqiptar

Drita MIFTARI

Abetarja shqiptare, me një histori prej 180 vjetësh, përfaqëson një përpjekje të vazhdueshme për të gjetur rrugë më të përshtatshme për emancipimin e popullit të vuajtur dhe të dëshpëruar. Ajo është shprehje e dëshirës për të gjetur metoda të mbështetura për nxënësit e shkronjës shqipe, si një parakusht për zhvillimin e dijes dhe identitetit. Përmes rrugës së abetares, shqiptarët kanë pasur mundësinë të shpalosin vetëdijen e tyre për përkatësinë kombëtare. Shumica e këtyre abetares janë botuar jashtë vendit, një fakt që reflekton situatën e vështirë dhe sfidat në përhapjen dhe njohjen e gjuhës shqipe, si dhe në ngritjen e vetëdijes kombëtare. Në qytetet si Bukureshti, Athina, Selaniku, Brukseli, Firenca, Milano, Vjena, Parisi, Stambolli dhe Sofja, shqiptarët kanë gjetur hapësira për të shtypur abetarët e tyre. Pirro Misha, drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, vlerëson kontributin e abetares në procesin e emancipimit kombëtar. Ai thekson se nga viti 1844 deri në vitin 1942, abetarët e para shqiptarë janë pjesë e rëndësishme e historisë së

kombit. Përfaqësuesit më të shquar të kësaj periudhe, si Naum Veqilharxhi, Konstandin Kristoforidhi dhe Sami Frashëri, kanë lënë një trashëgimi të çmuar në fushën e arsimit dhe identitetit kombëtar. Botimi i abetares jashtë Shqipërisë është dëshmi e situatës së vështirë në vend dhe sfidave në rrugën e lëvrimin, njohjes dhe përhapjes së gjuhës shqipe. Ndërkaq, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë shërben si një qendër e rëndësishme për ruajtjen e kësaj trashëgimie kulturore. Frrok Kristaj, shkrimtar dhe veprimtar kulturor, pjesëmarrës në botimin e abetares së Zymit, shpreh rëndësinë e kësaj abetare për historinë e arsimit në Kosovë. Ai thekson se abetarja e Zymit, e botuar në vitin 1900, është një ndër abetarët e hershme në trojet shqiptare dhe tregon historinë e arsimit në këtë rajon. "Kur unë e kam lanë arsimin, e kam kaluar në gazetari, në gazetën "Rilindja", më ka ra në dorë një artikull që është botuar në gazetën arsimore të Shqipërisë "Mësuji", që bënte fjalë për abetarën e Zymit. Abetarja është me alfabet të Stambolli, i mungojnë 3 shkronja, të cilat nuk kanë ekzistuar asokohe. I mungon shkronja ë, ç

dhe xh, janë të shkruara vetëm me njërin prej tyre, domethënë pa "q" dhe "gj". Alfabeti i gjuhës shqipe, që është përdorur në abetaren e Zymit i ka 33 shkronja. Ishte koha e Perandorisë Osmane, Shkruan 'Abetarja e Zymit' 20 maj 1900, po nuk përmendet shtëpia botuese. Nuk e dimë nëse ka ekzistuar edhe më herët. Nga sllavishtja nuk ekziston asnjë fjalë, por ka shumë turqizma. Për të ardhur deri te një tekst shkollor, duhet të kemi përvojë shkollore bile nja 100 vjet ma herët. Sepse nuk është e mundur që në ditën e hapjes së shkollës të krijohet edhe abetarja. Nuk përmendet autori, por supozohet se ka qenë Lazër Lumëzi, për shkak se ai është quajtur edhe Lazër shkollari. Është koha kur janë fshehur autorët e abetares, sepse dihet se si e pësuan disa nga regjimet greke e serbe të asaj kohe. Dihet se pësoi Naum Veqilharxhi. Në vitin 2011 u botuan 1000 ekzemplarë të abetares së Zymit. "Klubi Shqiptar i Kumanovës", në vitin 1911, botoi " Abetarën e Kumanovës" nga atëdhetari Jashar Erebara. Ajo ishte e rëndësishme për gjuhën dhe të shkruarit shqip, si dhe për arsimimin e shqiptarëve në Kumanovë dhe

rrethinë. Ishte një faqe e vetme e shtypur në njërin anë të gazetës "Shkupi", në mes viteve 1911-1912. Prof. Dr. Naser Zabeli, një nga bashkautorët e abetares së përbashkët të shqiptarëve, shpreh rëndësinë e këtij teksti si një udhërrëfyes për të ardhmen. Ai vlerëson punën e bërë në hartimin e një abetare të përbashkët, që synon të promovojë një gjuhë të përbashkët dhe identitetin kombëtar. Qysh nga abetarja e parë e Veqilharxhit që paralajmëroi lindjen e një periudhe të re në historinë e shqipes, Rilindjes sonë, rruga drejt emancipimit dhe afirmimit të gjuhës shqipe është një proces i gjatë dhe i mundimshëm, por që ka dhënë fryte të çmuara për popullin shqiptar. Rëndësia e saj ishte si një gur themeltar për faktin se gjuha jonë është një nga gjuhët më të vjetra, por është një gjuhë e shkruar relativisht vonë. Sot, është e domosdoshme, që të gjenden rrugët, për t'ju treguar dhe rrënjësuar atyre që vijnë pas nesh, se sa e vështirë ka qenë rruga e përpjekjeve, për të mos u asimiluar dhe për të, mos u zhdukur gjuha shqipe.

RTK (Qyteti i Librave)

NEHAS SOPAJ, shkrimtar

VETVETES IA BËJME VALLEN E DJALLIT

Në defilimin publik të shfrenuar të jovlerës përzier me vlerën, druaj se të gjitha institucionet, gazeta, portale e revista letrare, katedra e katedra gjer te akademitë tona të cilat do të duhej të merreshin me ndarjen e shapit prej sheqerit, mjerisht të gjitha sot nuk janë imune nga kjo e keqe që na ka rrethuar dhe po na han së brendshmi. Përkundrazi, gjithkund i ke të përziera deri në atë përmasë sa të ngulfat kiçi, shundi dhe letërsia triviale përmbi letërsinë e shijes së mirë, letërsinë artistike



Shkëlzen HALIMI

Në mesin e pak krijuesve, që u afirmuan në fillim të viteve '70-ta të shekullit që lamë pas, është edhe pena krijuese e poetit, prozatorit, dramaturgut, përkthyesit, kritikut, studiuesit letrar dhe profesorit universitar Nehas Sopaj. Për më se dyzet vite rresht, në kontinuitet të pandërprerë, ai e formoi dhe profilizoi personalitetin e vet, duke u radhitur në mesin e shkrimtarëve të pranuar në shkallë kombëtare. Sopaj është autor i më se dyzet vëllimeve të zhanreve të ndryshme letrare. Me punën dhe veprën e vetë letrare ka dëshmuar, se është pa dyshim një nga zërat më autentik, më serioz dhe më emblemantikë të kohës. Sopaj u lind në Sllupçan të Kumanovës, ku edhe kreu shkollën fillore dhe të mesme, kurse studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Shkup. Magjistroi në temën dhetëmesme, kurse studimet përgjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Shkup. Magjistroi në temën "Tipologjia e dialogut në romanin shqiptar në Jugosllavi", kurse doktoroi në temën "Rrëfimi në romanin monologjik shqiptar". Aktiviteti letrar dhe kulturor i N. Sopajt është mjaft i pasur dhe i larmishëm. Ka marrë pjesë aktive në shumë manifestime, konkurse letrare, simpoziume, seminare të gjuhës dhe letërsisë, ku

është kurorëzuar me çmime dhe nderime kombëtare dhe ndërkombëtare. **Disa nga veprat e tij janë: "Këngët e blerta"** (poezi), **"Algje"** (poezi), **"Të fala prej hënës"** (poezi), **"Në rreth"** (poezi), **"Gjysmëhëna"** (poezi), **"Gjëmat e gjëmisë"** (tregime), **"Letër Lirijes"** (tregime), **"Himeret e harbuara"** (poezi), **"Në fund të Akeronit"** (tregime), **"Lulet e verdha"** (poezi), **"Çapini"** (dramë-groteskë), **"Rrëfimi në romanin shqiptar"** (studim), **"Fluturimi mbi Sllupçan"** (roman për fëmijë), **"Paralelet letrare"** (studime), **"Rruga e gafferres"** (roman), **"Unaza e humbur"** (roman), **"Shpalimi i herbariumit"** (studime letrare), **"Individualitete letrare I - Beqir Musliu"** (studim), **"Individualitete letrare II - Teki Dërvishi"** (studim), **"Vallja e vdekjes së verdhë"** (trilogji), **"Individualitete letrare, letërsia bashkëkohore"** (studim) etj.

HEJZA: A mjafton fakti se sot, meqë kemi shumë shkrimtarë që "po shkruajnë", mund të konstatojmë se po bëjmë letërsi?

SOPAJ: Do të kujdesem që përgjigjet t'i kem të sakta, në të vërtetë, do të përgjigjem pikërisht për atë që po më pyet. Them se kuantiteti e garanton kualitetin, por jo përherë. Në të vërtetë, në rininë e hershme, në kohë të studimeve në Shkup, mbaj mend se ndaja

mendimin dhe thosha se do të vijë koha kur të gjithë do të shkruajnë dhe kjo gjë me të vërtetë erdhi. Dhe, kjo gjë nuk është gjë e keqe, e keqja qëndron në faktin se selektuesit e vlerës dhe të jovlerës, janë në margjina, ata nuk i pyet kush. O zëri i tyre s'dëgjohej ose edhe nuk përfillet, më saktë në turbulencat kulturore dirigojnë turbulencat e politikës së ditës, e cila në ambientin dhe kohën kur po jetojmë, është timon i të keqes në të gjitha sferat e shoqërisë shqiptare. Po, po bëhet letërsi e mirë, mbase edhe më mirë se sa në kohën e "lumturisë kosovare" të viteve '70 të shekullit të kaluar kur pat shpërthyer një entuziazëm i madh dhe kur vlerat e vërteta vlerësoheshin, por kjo letërsi tash me të vërtetë kërkon një mbarështrim dhe sistemim, i cili mjerisht është në duar të anarkisë globale... Në defilimin publik të shfrenuar të jovlerës përzier me vlerën, druaj se të gjitha institucionet, gazeta, portale e revista letrare, katedra e katedra gjer te akademitë tona të cilat do të duhej të merreshin me ndarjen e shapit prej sheqerit, mjerisht të gjitha sot nuk janë imune nga e kjo e keqe që na rrethuar dhe po na han së brendshmi. Përkundrazi, gjithkund i ke të përziera deri në atë përmasë sa të ngulfat kiçi, shundi dhe letërsia triviale përmbi letërsinë e shijes së mirë, letërsinë artistike.

HEJZA: Pse sot nuk kemi gjenerata krijuesish si dikur, që në viset etnike jashtë atdheut, po shënonin "epoka letrare": gjenerata e Pasluftës së Dytë Botërore, gjenerata e viteve 70-80-90! Ku qëndron problemi: te shkëputja e kontaktit krijues-lexues, te "heshtja krijuese" si pasojë e shkëputjes kohore, e cila kërkon një hedhje të hapit gjigant në krijimtarinë letrare, apo si pasojë e "vdekjes" së kritikës letrare?

SOPAJ: Sot kemi shkrimtarë shumë të mirë dhe me vlera të pakontestueshme artistike të të gjitha gjeneratave. Sot madje, më mirë se kurë janë krijuar mundësitë që krijuesit shqiptarë të komunikojnë mes vete dhe t'i për afrojnë kontaktet e tyre kur shkrija e kufijve shqiptaro-shqiptarë ditë e më ditë po bie, bile në planin e botimeve të përbashkëta, por e keqja po vazhdon të ekzistojë edhe më tutje deri në ekstrem për shkaqe nga më të ndryshmet, deri në ato më banalet. Kush, për shembull, i pengon shkrimtarët shqiptarë ta kenë një shoqatë të mirëfilltë mbarëkombëtare ku të gjitha problemet e krijimtarisë mund t'i sistemojnë dhe zgjidhin një herë e përgjithmonë, lehtë, mirë e qetë, me shpirtira demokratësh? Mbaj mend një tentativë të Zyhdi Moravës në vitet '90 që ta organizojë një shoqatë të këtillë. Dhe kaq. E di se

çështja e organizimit të shkrimtarëve në një subjekt nuk zgjidh problemin e anarkisë së shundit dhe të trivialitetit të sotëm letrar, por bile të keqen nuk duhet ta kërkohet nëpër subjekte minore, shoqata, botues dhe individë të caktuar, sidomos te ndonjë krijues eminent sado "fajtor" të jetë ai. Them, vetëm një organizatë e këtillë mund t'i japë përgjigje saktë pyetjes pse sot nuk ka gjeneratë të shkrimtarëve shqiptarë si ajo e "letërsisë shqiptare të viteve '70". Ne sot mund të flasim për një lëvizje të letërsisë shqiptare postkomuniste të viteve '90, por kjo mund ketë vlerën vetëm me letrarët e Shqipërisë së sotme me kuptimin e ngushtë të fjalës, por jo edhe me gjithë letërsinë shqipe, asaj të Kosovës, Maqedonisë së Veriut etj. Hapja e kufijve shqiptaro-shqiptarë me rënien e komunizmit, sado ta mendojmë si ngjarje spektakolare që të na duket, nuk shënon diçka që mund ta cilësojmë si epokë e letërsisë. Nëse me nocionin "epokë letrare" e kemi menduar letërsinë shqipe në përgjithësi, atëherë kjo është një temë shumë e gjerë dhe për të folur për të, duhen studime dhe libra të tërë që një ditë patjetër se do të lindin. Dy pikat tjera, heshtja krijuese dhe vdekja e kritikës letrare, sado që i shtroni si rastësi, ato meritojnë përgjigje të vëmendshme dhe jo dosido. Në fakt tema "heshtja krijuese" është çështje e aktit subjektiv krijues që i tangon secilit krijues, mënyrës se si ai di ta përdor atë akt të krijimtarisë së tij. Krijuesit në përgjithësi heshtin kur e heshtin të tjerët, heshtin kur i ndjekin dhe i persekutojnë ata, heshtin edhe atëherë kur u duket se po i ndodh kjo gjë më e keqe – ndjekja p.sh. (kujtoni vetëm Kafkën dhe Procesin e tij), por ka edhe faza të caktuara kur krijuesit për shkaqe objektive, por edhe subjektive, thjesht heshtin. Ka krijues kur edhe thjesht heshtin, sepse shteren, e këpusin krijimtarinë e tyre letrare, sado që lexuesit duan ta dinë pse po heshtin edhe kur ata (krijuesit pra) s'kanë përgjigje për këtë pyetje... Tema tjetër, vdekja e kritikës letrare, është temë shumë, shumë më e gjerë dhe atë duhet analizuar, duke e krahasuar me kohën kur krijojmë ne sot si krijues. Kanë ndërruar gjërat, kanë ndryshuar shumë fenomene shoqërore, që këtu edhe kritika ka ndryshuar. Nëse mendoni për kritikën letrare që tradicionalisht e ka shoqëruar veprën letrare të akcilit krijues pas botimit, kjo sot po vazhdon të shoqërohet pothuaj detyrimisht me një ritual të promovimit të veprës së tij në të cilën, të gjithë e dinë se në ato çaste ekzaltimi nuk thuhet mendimet e sakta kritike letrare, por fjalë miradie, shpesh kurtuazie. Nëse e kemi fjalën për kritikën e mirëfilltë letrare, jam dakord se ajo nuk hesht, por nuk po funksionon si duhet.

HEJZA: A mund të ketë kritikë bashkëkohore letrare në kohën kur po na ngulfat amatorizmi dhe diletantizmi në bërjen e "letërsisë"?

SOPAJ: Unë e di se kritika letrare ka mision fisnik, shkruhet që ta ndihmojë letërsinë në drejtimin që t'i interpretojë veprat e mira letrare, të merret me ato, krijohet dhe përpiqet ta krijojë shijen e mirë të lexuesit përmes veprave të autorëve të mirë dhe jo të kundërtën, të ndihmojë të krijojë amulli në rrëmujën e akulturimit çfarë mjerisht po ndodh te ne sot, në sy të botës së qytetëruar. Është për të ardhur keq se si po shtohet stogu i librave nëpër bibliotekat tona, diçka për të cilën M. Servantesi e shpiku Don Kishotin, kalorësin që qe çmendur së lexuari vepra pa etikë dhe pa vlerë. Ka krijues që e dinë shkrim-leximin, por që mjerisht s'dinë ç'është letërsia, cila është detyra parësore e shkrimtarit, ta fisnikërojnë gjuhën apo ta bastardojnë atë. Kritika e mirëfilltë letrare nuk mer-

ret me çoroditë shoqërore, nuk ka pse bashkërenditet me kakofoninë epokale që ndodh sot, thjesht e tund kokën para kolonave të tirazheve që po shumohen përditë, nuk merret me dukuri lukunish që do ta turpëronin çdo njeri normal. Po, s'ka kush merret me këtë dukuri të tmerrshme dhe të lig. Të shkretët "autorë" me ambicet e sëmurura! Dhe vetëm kaq. Ka perënduar koha kur kritika letrare merrej me "krijimin e njeriut të ri", me çka në të kaluarën kritika e realizmit socialist, në vend që ta shëronte njeriun, në të vërtetë vetëm e sëmurte atë. Mjaft më. Jemi në kohë tjetër, detyrat e ministrive nuk janë të stimulojnë paçavure idiotike që neverisin me shije të keqe, prandaj nisni të bëni punë të mbara. Më keq se sa librat me toponominë e përdhunës që na bënte pushteti antishqiptar në kohë të komunizmit kur e gjuante gurin dhe e fshihte gurin, vetvetes ia bëjmë vallen e djallit, duke stimuluar shundin dhe qiçin. Kritika e mirëfilltë letrare nuk merret me këtë gjë, me këtë gjë duhet të merren partitë tona në pushtet.

HEJZA: A shihni ndonjë rol në profilizimin e krijuesve të mirëfilltë nëpër portale apo redaksi elektronike gjithëkombëtare që do të ishin nën përkujdesin institucional të shteteve tona shqiptare?

SOPAJ: Portalet dhe redaksitë elektronike janë të një kohe më të re, shumë më të re se sa koha jonë, në të vërtetë disi më duken paksa artificiale se sa redaksitë klasike, shtëpitë botuese ose edhe libri në kuptimin klasik të fjalës. Roli i redaksive ose shtëpive botuese, si në të kaluarën, por edhe sot, presupozon kontaktin e drejtpërdrejtë të shkrimtarëve që d.m.th. presupozon një afërsi fizike të tyre, prandaj s'ka si mos të jetë më i afërt dhe më ngrohtë kontakti i drejtpërdrejt, se sa portalet dhe redaksitë elektronike ku aktantët as shihen e njihen mes veti, të cilët nuk i detyron krijuesit të kenë kontakte fizike. Ajo që më intrigon dhe më shqetëson është nocioni "libër elektronik", prandaj desha të flas pak më gjerë për të. Ne jemi në tranzicion, jemi thellë në performime të natyrave të ndryshme. Epoka e postmodernizmit na ka gjetur shumë të shtyrë për nga mosha që të mund të flasim për ndryshimet që na presin. Libri elektronik? Portale? Komunikim me internet? Po kush mund të flasë sot saktë se si do të do të zhvillohet letërsia në këto performime përballë letërsisë të cilën e dimë më së miri, librit klasik! Krijuesit e mirëfilltë dhe me talent, kjo nuk i tremb. Me të drejtë, sepse arti i fjalës në këto performime, megjithatë është i njëjtë. E ashtuquajtura letërsi kalorsiake të cilës i referohet Servantesi, gjithë ato libra pa vlerë që një kohë vigjilonte në Mesjetë nuk janë më, askush s'di për ata autorë dhe ato vepra, të gjithë i ka shpuzuar koha, por ka mbetur Don Kishoti i Mançës që vazhdon të mbetet monument kohe që e ka varrosur gjithë atë letërsi shundi. Letërsia e mirë vazhdon të mbetet e pavdekshme, letërsia e keqe e ka kohën të shkurtër. Tash për pyetjen. Mua realisht më tremb mendimi se mund ta profilizojnë një shkrimtar mjetet elektronike, qofshin edhe portalet, qofshin çfarëdo mjeti tjetër elektronik. Shkrimtari është ose nuk është shkrimtar, mjetet me të cilët defilojnë shkrimtarët, më së paku mund t'i bëjë kush të profilizuar, prandaj as portalet... Për fund, më duket se këtu në metamorfizimin e fjalës së bukur artistike nga fjala e shkruar në fjalë të dëgjuar, fillon edhe vdekja e librit klasik me kuptimin e plotë të fjalës. Nga fjala që shihet kur shkruhet, preket dhe ndjehet, me anë të vizualitetit (psh. librat megafonik, librat që vetëm i dëgjojmë), fjalës duket sikur i humb diçka nga arti i saj

në shqisën e përjetimit shpirtëror, diçka që humb në ndjeshmërinë fikzionale.

HEJZA: Librin elektronik, bibliotekën elektronike, digjitalizimin e botimeve, e shihni si "vdekjetëlibrit" aposinjëproces të cilin, detyrimisht duhet ta pranojmë dhe të jemi në hap me kohën! A mund ta konceptojmë këtë proces të librit si fati i shkrimtarit të pergamenëve, të shkrimtarit nëpër lëvore drush, në rrasa guri, në lëkurë kafshës, në shpat mali, në shpella!

SOPAJ: Pyetjes suaj po ia bashkëngjis diagramin e të dëgjuarit gjithë-shqisor që ka letërsia. Kur po përmendni të gjitha tipologjitë e evolimit të librit që nga zanafilla, ju sikur po ecni në të gjitha kohërat njëkohësisht, diçka si postmodernizmi, rrugë në të cilat ka ecur libri ose shkrimi që nga pergamentet, "shkrimi nëpër lëvore drush, në rrasa guri, në lëkurë kafshës, në shpat mali, në shpella" etj. në të cilin ju pavetëdijshëm po bëni një ridefinim në retrospektivë të librit të vogël të F. Engelsit "Roli i punës në transformimin e njeriut nga majmuni", ku "majmuni, lexo njeriu i ri" sikur po i kthehet paragjenezës. Llogaritni sikur një ditë të shterojnë të gjitha resurset e rrymës elektronike dhe gjendeni në situatën kur s'dini ç'mund të bëni me të gjitha ato portale e shtëpi elektronike, ku fati i librit mund të ngel në mëshirë të një çelësi apokliptik kur supozimi se një ditë të ndodh në realitet, të gjitha librat t'i fshijë mungesa e rrymës elektrike. Vdekja e librit elektronik në të vërtetë na kthen në paragjenezë, në lindjen e dytë fizike si libër klasik.

HEJZA: A po e vuan kritika jonë letrare mungesën e gazetave dhe revistave kulturo-letrare! Nga ana tjetër, janë të pakta edhe përplekjet e kritikës sonë që të gjejë vend e strehë nëpër faqe profesionale, nëpër rrjete sociale të profilizuara, ku mund të japin kontribut të pamohueshëm.

SOPAJ: Kritika letrare lind për shkak të letërsisë së mirë, e cila për fatin tonë të mirë, ajo te ne nuk mungon, sado që ka shtegtuar nga revistat standarde drejt portaleve ose anasjelltas. Paradoksalisht, përderisa një letërsi kombëtare si e jona është në lulëzim të plotë me kuptimin e plotë të fjalës kultivohet gjithnjë e më mirë, lexuesit profesionist alias kritika letrare ngel e patrajtuar institucionalisht, ajo nuk e ka vendin atje ku duhet të ketë, të jetë e përkrahur dhe e financuar për punën që bën. Nuk di të ekzistojë ndonjë revistë profesionale, standarde dhe me jetëgjatësi siç, le ta përmend këtu me këtë rast, revistën "Umjetnost rijeni" (Arti i fjalës) të Zagrebit, e cila me dekada botohej pareshtur që në kohë të Ish Jugosllavisë, organ i pastër kritik letrar, të cilit ia kemi për borxh për mbathje teorike ne të kësaj pjese të Shqipërisë. Kanë avulluar rubrikat e kritikës letrare të Jetës së Re, Jehonës, Fjalës, kanë lindur dhe kanë perënduar sapo kanë lindur shumë revista periodike, botime ekskluzive me tekste të kritikës letrare dhe edhe sot, të tre Shqipëritë tona nuk e kanë për nge të financojnë një organ me kritikë pastër letrare, me njerëz kompetentë të ngritur në nivelin standard akademik që mund ta përcjellin hiperproduktionin letrar që do një krah ndihme për zhvillimin normal të letërsisë sonë shqipe. Ata që të parët duhet të mërzhiten, janë njerëzit e kulturës dhe institucionet e saj, sepse çdo kohë e kaluar me vepër të mëdha të letërsisë pa shënime kritike, pa debate kritike letrare, pa polemika konstruktive ku mund të ndahet shapi prej sheqerit, pa të dhëna qofshin ato edhe më minimalet bibliografike të mendimin kritik të kohës kur bashkëjetojnë shkrimtari i madh dhe kritika e saj letrare përbri, kjo na ngjet si buka pa kripë.



Qan dhe qesh Talia

TEATRI JASHTË VETES

Kush e shkatërroi Teatrin Kombëtar? A ka adresë ku duhet të trokasim, apo fajtori banon diku klandestin, me qira...



Nga Agron GËRGURI

Nëse konstatojmë se Teatri është në krizë, jo si manifestim por si art, do t'i kemi vënë vetes detyrë të ngremë institucionin e debatit të munguar?! Edhe pse vazhdimisht konstatojmë se na duhet debati që të filtrojmë gjendjen, dikush, për ta mirëmbajtur krizën, hoqi edhe ato pak debate që bëheshin në festivale të teatrove. Nëse nisemi të gjejmë fajtorë e faktorë, hasim në mirëqenie doslakishë në produktimin teatror! Disa të tjerë argumentojnë se shkaktarë të krizës janë ata që do duhej të ishin bartës të zhvillimit të teatrit si institucion dhe si art, fakulteti, teatrot publike, aktorët "yje" që kënaqen me seriale e diku - diku edhe si karrem i politikës për të vjelë vota. Disa thonë se fajet i ka dramaturgjia, e cila po gazetarizohet. Ka tjerë që për këtë gjendje e akuzojnë administrimin e tepërt të kulturës në përgjithësi dhe artit në veçanti. Tashmë shumë prej atyre që e bëjnë artin teatror janë trajnuar apo janë në proces të trajnimit për të mos çarë kokën për produktin artistik, kryesorja të jesh mirë me letra. Krejt në fund apo në gjenezë fajin e ka shoqëria e akomoduar në mungesën e sistemit të vlerave?! Këtu ironia bëhet fakt dhe çështja bëhet edhe më shqetësuese? Duke qenë se Teatri si art sublim sigurisht se i ka edhe arsyt "objektive" të ngecjes apo të humbjes së rrugës deri te spektatori...?! Ashpërsia e mediaveve tjera të digjitalizuara ka "blerë" shumë prej spektatorëve dhe krijuesve të mundshëm teatror ... dhe i ka blerë shumë lirë?! Por, teatri i zënë ngushtë sikur këlthet: mos më digjitalizoni, sepse vetëm ashtu siç më ka bërë Dionisi, Thespisi, Eskili, Shekspiri, Çehovi mund të jetoj. Shembull është, po e zëmë Japonia, ku digjitalizimi i jetës ka shkuar larg, por Teatri ruhet ashtu siç është që nga lindja, me njeriun për njeriun! Tjetra është se dikur teatri, artisti - aktori, shkrimtari, regjisori përjetoheshin apo ishin "të tjerë", ishin TABU - FETISH dhe kjo sikur i ka mbajtur dhe të kultivuar si të veçantë. Sot, duke mos pasur një sistem të qëndrueshëm vlerash, kemi një ngatërrim kriteresh, ndërsa edhe pse ka ndodhur detabuizimi, defetishizimi, mirëpo është prish rrëfimi,

stisur përjetimi e ka humbur kuptimi. Teatri, ngjashëm si gjithë shoqëria, u fut në qorrsoakun e krizës së vlerësimit apo në vakumin e sistemit të munguar të vlerave, ku shumëçka lëvizë e askund nuk shkon...suksesit i mbetet dëshmimi në fb, instagram. Pra, rrjeti social bëhet kriter. Nuk u gjend autori, nuk u bë repertori, nuk u zu spektatori, iku tema u objektivizuar, ideja, gjithçka u shndërrua ne rutinë aty ku mbretëron skllavërimi i kreativitetit! Fundja, në teatrin kosovar (lexo shqiptar) nuk është profilizuar thuhaja asgjë: as zhanret, as stilet, as meta shprehjet teatrorë, as llojet e teatrit (teatri social, teatri i padukshëm, çehovian, shekspirian, kamertal). Teatrin e ka prekur virusi i monotonisë, amullisë dhe provincializmit në njërën anë, ndërsa në anën tjetër kemi teatër manifestiv, një lloj teatri publicistik, të cilën e stimulon dramaturgjia bulevardeske, e cila e ka humb personazhin në përpjekje për të kapur problemet si perceptim publik. Më e keqja është se mungon dashuria për artin teatror, përkushtimi, sinqeriteti në qasje, vullneti në veprim, mungon kritika teatrorë, ka sa të duash vetëmjaftueshmëri, por mungon autoritetit krijues, jo - meskin. Përveç lirisë në shprehjen e dëshirave seksuale eksplicite në skenë të sjella nga jashtë, asgjë tjetër. Qeshje ironike, urime hipokrite për sukses, derisa e vërteta rri e struktur dhe pret artistin. Meteorologë të kësaj klime janë kryesisht aktorët që thirren në tituj, studentët ambiciozë që qëllim e kanë diplomën dhe kapjen e ndonjë projekti, regjisorët që kanë smirë ndaj njeri tjetrit, "bardët" e teatrit me nga një rol dytësor në karrierë, profesorë të kënaqur me statusin e vetëmjaftueshmërisë. Profesional me bindje, talente për imitimit, "resurse" të shterura nëpër rrjetet sociale. E skena pret rrëfimin, emocionin dashurinë, përkushtimin, veçantinë artistike për të thënë diçka për sot e reflektuar nesër për njeriun. Skenës teatrorë aktuale i mungon serioziteti i Muhareem Qenës, trema mobilizuese e Istrefit, figura markante e Avdushit, sinqeriteti i Farukut, përkushtimi artistik i Ismet Azemit e tjerëve që janë jashtë zhurmës e britmave shurdhuese për sukseset e dështimeve ?!. Nuk i mungon as

kullerizmi dhe të qenët (lexo ndenjurit) jashtë vetes pa profil. Shkurt, është tepruar me mësimin se teatri është lojë dhe vetëm lojë edhe kur abuzohet me rregullat e lojës. E spektatori ikën, sepse mungon jeta në teatër, mungon rrëfimi me njeriun në qendër, është prishur iluzioni mbresëlënës, maska e çjerre prolog nuk mblidhet dot në epilog. Shfaqjet të ngarkuara me modernitet e postmodernitet pretendojnë të kapin probleme përmes të ashtuquajturit diskurs, edhe kur nuk dihet kursi! Është prishur muri i katërt e ka rënë çatia e estetikës?! Ka hipur spektatori në skenë, e aktori nuk mbeti as spektator? Kur ta hapim kutinë e Pandorës (lexo Talias) dëgjojmë britmat: ka, nuk ka teatër, banalitetë që prishin metaforën, kurtuazitete në foajet e teatrove, urime me buzëqeshje të uthullta për suksesin...Në ndërkohë spektatori po ikën e në ende nuk e dimë peshën specifike kur matemi me vetveten... Fabrikime pafund të madhësisë së paqenë?! Gazetarët heshtin kur duhet shkruar, shkruajnë kur duhet heshtur. Nganjëherë duke vënë veten në shërbim të ndonjë të "keqtrajtuar" ne rrugën e afirmimit "afirmohen" vetë duke u bë palë simpatizuese?! Teatri është sikurse jeta, një tkurrje e jetës ku kriza (problemi) shihet më ngushtë, por reflekton më qartë. Duke mos qenë sot kështu ngase teatri u mbush me mikrofonë e video, u digjitalizua në garën e autorëve për t'ju ngjitur aktualitetit që po e vrasin teatrin, pikërisht gjallërinë e drejtëpërdrejtshmërinë, e cila e shquan nga artet tjera. Natyrisht, ndikimi spontan i tij në jetën shoqërore e ka humbur teatrin duke vrapuar pas trendeve apo asaj që e quajmë eksperiment apo avangarde e emocionalizuar dhe pa domethënie. Teatri nuk të dërgon askund tjetër, përveçse te njeriu që është qëllim final i ekzistencës për të mos thënë i mision të teatrit prej antike e këtej. Po ta kishim përfillur, po e zëmë, mendimin dhe praktikën e Artos, teatri do duhej të përcillte tematikisht nën lëkurë ndryshimet në shoqëri... E keqja është se në salto-mortalet e tranzicionit, kulturës i është thënë prit në rend... Teatrit vazhdo konfliktin, fute edhe pak

intrigë...rrite zogun e qyqes derisa një ditë ai t' i nxjerr sytë. E ne? Kënaqemi si Jago, e kemi shaminë e Dezdemonës në dorë, intrigën mund ta zhvillojmë tutje Jagos, derisa ta shkatërrojmë tjetrin. Harrojmë se ai tjetri jemi ne.....e jo Othello?! Dikur Teatri e kishte qetësinë e tempullit fetar... joshjen e shtëpisë publike, dua të them kishte intimitet (lexo identitet) që sot i mungon. Politika e ka eklipsuar të vërtetën, të cilën e detekton teatri që sot është jashtë vetes. Adhurimi për Begollin, Hasanin, Petrovcin, Pallaskën, Fehmiun është zëvendësuar me politikanët, madhërohen analistët që e kanë të sofistikuar sensin e shpërfaqjes së vetvetes përmes problemeve të kësaj shoqërie, ashtu siç e bëjnë edhe përmes përgojimit të problemeve kulturore (e teatrorë në kontekst) sa herë që atyre u bije ndërmend, e jo sa herë ka nevojë, pa koherencë, e kriterë. Kur kritikojnë amatorisht, nxjerrin titujt akademik si argument në fund të gazetës, sa për t'ju besuar?! Ata i dinë gjërat më "mirë" se, po e zëmë, Josif Papagjoni, Emin Emini, Agron Gërguri, Primo Shllaku, Besim Rexhaj... hije mbi tjetrin, hijeshi askund...?! Këlthasin mungon kritika teatrorë derisa nuk i lexojnë. Mujshorët mediatik nuk qajnë hallin të vënë kritere për vlerësim kritik, e as për kritikët teatror e të artit në përgjithësi! Teatri po vuan nga dija e mosdijes... se e ka ngulfatur zhgënjimi nga sukseset... se e mbyti amatorizmi në krijimtari e mungesa e amatorizmit në qasje... S'ka dashuri, ka interes do thonë njerëzit praktik...Biznesmenët e ashtuquajtur kulturor e teatror, të cilët jo rrallë i bëjnë politikë kulturore, duke i estradizuar e fejsbukizuar. Sa herë flitet për tepricë administrative, ato shtohen? Kush e shkatërroi Teatrin Kombëtar? A ka adresë ku duhet të trokasim, apo fajtori banon diku klandestin, me qira... Derisa ta gjejmë adresën e saktë dhe të ngremë zërin pa të keqen e askujt, na mbetet të trokasim tek ajo që na rri mbi qafë, gjithsecili prej nesh që, hajt po them, kemi njëfarë brengje për gjendjen artistike dhe institucionale të teatrit sot?!

Ngjarje

NJË DISK QË NUK ËSHTË VETËM NJË PLLAKË E GRAMAFONIT

Ky shkrim është botuar më 27 nëntor 1974 në gazetën e Shkupit, "Flaka" dhe i është kushtuar këngëtares sonë të famshme, Nexhmije Pagarusha

Nga Bajram SEFAJ

Në kohën tonë, të sotmen tonë, të lumtur e të gëzuar gjithsesi, kur kënga, kur arti muzikor na ka pushtuar të gjithëve, duket pak e çuditshme, jo e zakonshme, të thuret një shënim, një raport i angazhuar, pri nga mbititulli i lartshënuar. Lexuesit më të ri (e të nderuar) të gazetës sonë, ndoshta do të më thonë buzagaz, derisangaragetetyreinxjerrinalbumet, long e singël, stereo e ku ta di unë fare se çfarë disqesh të reja të Roling-stonesve, Xhimi Hendriksëve (i Grupit "MI" "YU" e kështu me radhë. Prindërit e këtyre fëmijëve të shkapërderdhur pas tërë atij deti disqesh që vijnë e kah vijnë, duke ngritur, në këtë mënyrë, disko grafina në piedestal të një branshe të rëndësishme industriale, besoj se në anën time janë... Nuk është kjo pllakë e zakonshme gramafoni...! Djem e vasha të reja (më lejoni t'ju drejtohem kështu) tërë ata këngëtarë e këngëtare, që i përmenda e që nuk i përmenda, kush djallin ua di emrin të gjithëve - tëra ato grupe e ato AVI - ansamble të shumta që botën muzikore në këmbë e ngritën sa herë ashtu si erdhën, furishëm e brenda ditës. Lënë pas vetes ndonjë skandal e, lamtumirë. Ejani, prandaj, të bimë në ujdj - unë nuk

kam kah të iku nga Terry Xheksi e, lutja ime, në raftet tuaja të gjendet edhe disku i madh, edhe të madhes - Nexhmije Pagarusha. Jo, nuk është kjo as reklamë, as propagandë. Sepse, nuk është këtu fjala për disk të zakonshëm gramafoni. Nuk është fjala për mall të zakonshëm. Nexhmije Pagarushës, artit të saj, nuk i duhet kurrfarë reklame! Diskun nuk ka asgjë që mund ta zhdukë, as koha, as kohërat. Ai nuk vjetërohet, as nuk pluhuroset, as nuk harrohet... Nexhmija jeton në ne, me ne, ajo pret gjenerata të reja e të reja, me këngë të pret, me këngë të përcjell. Të shohim se ç'thotë, ç'shënon letrari ynë, Esat Mekuli, në mbështjellësen e këtij disku, të këtij disku që nuk është vetëm disk gramafoni: Rrafshi - rrethuar malesh vigane: me Sharrin njomak dhe të vrazhdët Bjeshkë të Nemuna, me Kopaonikun shpatullgjerë... Rrafshi-që s'kapet me sy! Në katër anë: Verës, i praruar nga grunajat e pjekura valëvitëse, dimrit, në argjend i shkrirë nga bora, që hije i ka si bukuroshes rrobat e nusërisë, në pranverë, si rrallë ku, ngjyrë ngjyrësh nga lulëkuqet dhe lulet e tjera, nga behari i kopshteve dhe plantacioneve, nga blerimi i ngjyrosur kudo. Në vjeshtë, i ngjirur nga këngët, i skuqur - buçitëse

i rënduar nga dasmat dhe bereqeti... Rrafshi - që, bashkë me bukuritë e tjera, e lindi dhe e rriti edhe Nexhmijen. Rrafshi - ku shekujt që ndërrojnë dhe e reja shpërthen pa u ndalur. Kubet e kishave, xhamive dhe hamameve - të lashta sarajet dhe kullat - fortësa të sundimtarëve pranë kasolleve varfanjake, por edhe - soliterët e lartë dhe siloet, tymtarët e hedhur të fabrikave, fshatrat e reja dhe qytetet, Autostradat që maten me lumenj: Drinin dhe Sitnicën, Bistricat dhe Ibrin... Pra, në këtë laramani bukurish dhe kohësh, kur ja thotë këngës Nexhmija - disi të pahit edhe pikëllimi i kurbetçinjve, edhe shkrumbi i të provuarve të të drejtave, dhimbja dhe rebelimi i dikurshëm, mospajtimi me padrejtësi dhe robëri, dhe - hareja e ditëve të sotme dhe hovi, i paparë i punës në liri të njerëzve të vëllazëruar që janë më të bukur e ndërtojnë për të gjithë... Kosovën - të cilën duhet ta shohësh e ta përjetosh, e ta ndjesh me tërë qenien... Pse ai që njëherë e sheh, do t'i mbetet në zemër përherë - dhe natyra e saj, edhe njerëzi bujarë të saj, edhe vallet e këngët e saj, që mahnitin gjithkënd i cili i sheh dhe i dëgjon. Në këto bukuri, në atë vrer dhe këtë

gazmend, mbiudheurrit në artistevërtet interpretuese - Nexhmije Pagarusha... Ajo që, gjuhën e shpirtin tonë për fshat pjellore dhe male flladitëse tona. Pikëllimin e thellë për kurbetçinjte që s'kthehen më, për të shpërngulurit, Dashurinë që, askund si këtu, në këngën e Nexhmijës, nuk të çon peshë, nuk të larton... Sepse - Nexhmije Pagarusha është, kjo thuhet moti: Bilbili i Kosovës, bilbil i këngës sonë në këtë truall! (Esat Mekuli) Citat jo ky, por tekst i përshtuar tërësisht, prapë do të më akuzojë një pjesë e lexuesve. Ashtu është - më mungon fuqia të ndërpris atë rrjedhë të qetë e të fuqishme, atë fjalë të matur që digjet në ngrohtësi. Të këpusësh këtë varg të kulluar poetik e të sakatosh me tri pika në fillim e po aq në mbarim, do të thotë të këpusësh këngën e Nexhmijes në akordin më të bukur, në frazën më të gjallë... Sepse - Nexhmije Pagarusha, nuk është vetë "bilbil i këngës sonë në këtë truall" - sikurse thotë poeti. Nexhmije Pagarusha, për të cilën njohësit e artit muzikor, thonë se ka zë të kristaltë, të kulluar - zë bilbili, me sukses shumë të madh - eci e eci. Në shumë podiume të njohura të vendase e të



botësmbarrë - meshpërblimin më të dashur, me shpërblim ndër shpërblimet - më të dashur, meshpërblim ndër shpërblime - me duartrokitje entuziaste u shpërblive. Kështu eci Nexhmije Pagarusha prej Tunizisë në Itali, prej Italisë në Çekosllovakë, prej Çekosllovakisë në Shqipëri e kudo andej shtegtoi bilbili i këngës popullore - Ambasadore këngë! Dhe - çdo kund, ama bash çdo kund, kudo qoftë, Nexhmija gjeti miq të vërtetë të muzikës, këngës... i gostiti ata, për t'i lënë me gishtërinjtë në gojë kritikët që me skepticizëm se atje në tribunë - mbretëshë e këngës është duke u rritur. Dhe - ngado që u kthye Nexhmija, u kthye ballëhapët e krenare. Sepse - në mënyrë të denjë e prezantoi këngën tonë popullore, koloritin e begatshëm të folklorit tonë në thesar... Kush është sot cikërrim-

tar e të bëj hesap se që kur në skenë u ngjiti Nexhmija, e kur para mikrofonit doli... Dihet - që nga dita kur në gji na vloi kënga - që nga ditët e para, pra, të çlirimit, të prirë nga Nexhmije Pagarusha - ia them këngës. Një jetë, pra, le të quhet këngë, le të quhet Nexhmije... Në muhabet, në kuvendim, më tepër spontan, gjersa në bufenë e Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë, bisedonim mbi "Akordet muzikore 74, që ja po vijmë me zë të qetë. Nexhmija më në fund, ka botuar long - play - disku i madh. Me gjersa marr kafënë e promocionit, ne fytyrën e Nexhmijes tonë madhe, vërej një zymti. E kuptoj atë dhe e ndjej atë zymti - në duet bashkë me të, veç që nuk filloj të akuzoj: A thua vallë, pikërisht tri decenie u desh të presim që punën e një artisteje të merituar, artisteje të pop-

ullit, ta kurorëzojmë me një disk? E "arnon" Nexhmija rrëfimin lidhur me botimin e këtij disku, të cilin tani, për fat të mirë, e kemi në duar, njashu sikurse e kanë "arnuar" botuesit (Produksioni i disqeve i RTV të Beogradit bashkë me Lidhjen Turistike të Kosovës, janë mbledhur copa gati të vjetruara dhe të grisura, të shiritave të magnetofonit, në të cilët, para shumë vjetësh, janë incizua dhe - kështu ia kanë dalë në krye të kompletojnë një disk, na thotë Nexhmija. Çudë, vërtet çudë, themi na, pse Radio Prishtina, ku pothuaj se lindi e u rrit Nexhmija, vërtet është e pavdekshme si artiste, por mjerisht jo edhe si krijesë njerëzore. Si u bë, pra, që më azhure, më e kujdesshme të jetë Lidhja Turistike (çdo respekt asaj) e Kosovës, ndaj Nexhmijes se sa njerëzit e kulturës, njerëzit e muzikës çfarë-

do qofshin ata, në të vërtetë çfarë duhej të ishin ata të Radio-Prishtinës. Veprat e vlerëshme çfarë janë këto të Nexhmijes, duhet të incizohen dhe të ruhen për mot e jetë. Por, gëzon e dhëna se, hiç vuajtjet e botuesit, në dritë ka dalë një vepër e madhe, bukur, solemne, një vepër e denjë emrit dhe reputacionit të kësaj artisteje të nivelit më të lartë... Në këtë disk (premierën e të cilin e shënojmë edhe me këtë tekst modest) të përgatitur për mrekulli, nuk janë të botuara 12 melodi, por 12 vepra të spikatura të artistes sonë të madhe, të pavdekshme...

P.S. Këtë shkrim të arkivuar diku në skedat e tij, i ndjeri Bajram Sefaj, na e pati dërguar pak para se të rëndohej shëndeti i tij. Dhe HEJZA e sjell në nderim të veprës dhe personalitetit të tij. Qoftë i përjetshëm kujtimi për mikun tonë, **Bajram Sefaj**

Profile: Aleksandër Stipçeviq

PERSONALITETI QË I KUSHTOJ JETËN MBROJTJES SË TEZËS ILIRO-SHQIPTARE

Ndihmesa e A. Stipçeviqit qëndron në parashtrimin e pikëpamjes së tij rreth origjinës së ilirëve, i vendit dhe rëndësisë historike të ilirëve në botën antike. Ai mbështet tezën se ilirët janë autoktonë në trojet e Ballkanit Perëndimor

Nga Muzafer KORKUTI

Arkeologu, bibliografi, letrari, es-eisti, e albanologu Aleksandër Stipçeviq, veç të tjerash ishte anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nderuar e dekoruar nga shteti shqiptar me medaljen "Naim Frashëri" dhe me urdhrin "Gjergj Kastriot Skënderbeu". Aleksandri u lind më 10.10.1930, në fshatin Arbanas pranë Zarës në Kroaci, në një familje me origjinë shqiptare, të ardhur rreth 300 vjet më parë, nga një fshat në zonën Ana e Malit në Mal të Zi. Origjina e familjes e rrënjës thëllë në formimin e tij, ishte një nga arsyet që kur ishte student i arkeologjisë në Universitetin e Zagrebit, kishte vendosur të merrej me ilirët, dhe këtë e shpreh qartë në një artikull, në formë interviste të botuar shumë vite më vonë ku shkruan: "Me ilirët kam vendosur të merrem që kur isha student i arkeologjisë. Ata vazhdimisht më kanë preokupuar, në radhë të parë për shkak se kam menduar e mendoj se nuk mund të studiohet e kaluara e Ballkanit, madje as e tashmja pa njohjen e elementit ilir. Gjithçka që ka ndodhur në Ballkan prej kohës së mesme e këndeje, në një farë mënyre, është ndërtuar mbi atë shtresë që ne e quajmë ilire. Pra çdo tregim për Ballkanin fillon me

Ilirët ("Bota e Re", Prishtinë 1985). Libri i parë i tij "Gli Iliri", Milano 1966, u përkthye në shqip nga Prof. Zef Mirdita dhe u botua në Prishtinë, 1967 nga Shtëpia Botuese "Rilindja". Përkthyesi e kolegu prof. Z. Mirdita, më dërgoi një kopje të librit dhe në respekt ndaj autorit e vlerësim të veprës së tij, botova një recension për studiuesit e lexuesit në Shqipëri (Studime Historike, nr. 4, 1968), ku ndër të tjera shkruaj: Vepra e A. Stipçeviqit, pas veprës së Karl Çaçit "Ilirët", Tiranë 1923, shënon një sukses të ri në fushën e ilirologjisë. Autori ka mundur të japë një pamje më të plotë të historisë dhe të kulturës ilire. A. Stipçeviq ka grumbulluar e sistemuar aspekte të ndryshme të jetës së ilirëve, të historisë dhe kulturës së tyre dhe ka arritur të bëjë një sintezë të gjithë asaj që ishte thënë e shkruar për ilirët". Kështu u njohu me autorin e veprës Ilirët, njohje e më tej miqësi, që nëpërmjet shkrimeve, shkëmbimit të literaturës nuk njohu ndërprerje për mëse katër dekada. Prof. A. Stipçeviq, me punën sistematike, me rigorozitetin e akribinë e kërkuesit në vjeljen e sistemimin dhe përgjithësimin e rezultateve të studimeve ilire, vazhdoi ta ripunojë, ta plotësojë e zgjerojë veprën e tij "Ilirët", e cila ka sot 9 botime e ribotime në katër gjuhë të ndryshme (italisht,

kroatisht, shqip e anglisht). Varianti i fundit dhe më i ploti është ILIRËT, historia, jeta, kultura e simbolet e kultit, Tiranë 2002, f. 514, botimet TOENA. Çdo njëra nga këto tema përbën edhe kapitujt e librit, ku secili është shtjelluar në detaje, thjeshtë e qartë. Kështu në kreun 'Historia' trajtohet emri ilir, etnogjeneza ilire, kufijtë etnikë e topografia e fiseve ilire, kolonizimi grek, shtetet kryesore ilire, luftërat iliro-romake dhe ilirët nën pushtimin romak. Ndihmesa e A. Stipçeviqit qëndron në parashtrimin e pikëpamjes së tij rreth origjinës së ilirëve, i vendit dhe rëndësisë historike të ilirëve në botën antike. Ai mbështet tezën se ilirët janë autoktonë në trojet e Ballkanit Perëndimor. Me rëndësi është qëndrimi që mban autori ndaj depërtimit të kulturës e të qytetërimit romak. "Ilirët në tokat e tyre, shkruan autori, vazhdojnë të flasin gjuhën e tyre popullore, i adhurojnë zotërit e vet, të vdekurit i varrosin në mënyrë tradicionale, e punojnë tokën ashtu siç e kanë kultivuar në shekuj të parët e tyre, veshin kostumet e tyre popullore dhe e përfillin rendin shoqëror politik të organizimit të tyre fisnor, që vetëm në rast nevojë ia adoptojnë strukturës së administratës romake". (Ilirët, Prishtinë 1980, f.70). Në sajë të qëmtimit të kujdesshëm

të burimeve të autorëve antikë e të dhënave nga zbulimet arkeologjike, autori jep për herë të parë një tok të dhënash me interes për jetën e përditshme e doket ilire, për lindjen, jetën e vdekje; për pijet, për veshmbathjen, për higjienën e sëmundjet. Shumë nga këto aspekte ilustron me objekte të kulturës materiale, objekte të përdorimit të përditshëm e objekte kulturi. Në punën e tij gati shteruese për çka është shkruar e botuar për ilirët A. Stipçeviqi rindërton jetën shpirtërore, religjionin, shfaqjet e totemizmit. Përpjekje bëhen për të nxjerrë nga thellësia e shekujve të dhëna për muzikën, vallet dhe për gjuhën e ilirëve. Për jetën ekonomike dhe marrëdhëniet shoqërore, autori në sythe të veçantë flet për bujqësinë, blegtorinë, gjuhën, peshkimin, minierat e kripës, prodhimin e qelqit, për piraterinë, tregtinë e rrugët tregtare, për monedhat dhe organizimin shoqëror të ilirëve. Aleksandër Stipçeviq ishte arkeolog kabinetit. Ai drejtoi për një kohë të gjatë Bibliotekën e Akademisë së Shkencave të Kroacisë, duke dhënë një kontribut të shquar në përpunimin metodik e shkencor të librit. Është autor i Bibliografisë ilire, i Bibliografisë antike të Jugosllavisë etj. Për punën gjysmë shekullore dhe formimin enciklopedik

të tij dëshmon edhe botimi i veprës "Povijest knjige" (Historia e librit), Zagreb 1985, f.560, shoqëruar me shumë ilustrime, e përkthyer në shqip dhe botuar në Prishtinë, 1988 e në Tiranë 2000. Rrëfimin për historinë e librit autori e nis me pllakat e shkruara prej balte të gjetura në Mesopotaminë e lashtë 4500 vjet më parë, me Bibliotekën e Aleksandrisë, me Shtypshkronjën e Guttembergut e deri tek libri elektronik. Dhe në fund shkruan: "Apo afrohet fundi i "Erës së Guttembergut", d.m.th i librit prej letre, apo do ta zënë vendin e tyre "Bibliotekat e ardhshme të kompjuterizuara të Aleksandrisë? T'ua lemë këtë, përfundon A. Stipçeviq, historianëve të ardhshëm të librit". Në vitet e fundit të veprimtarisë shkencore prof. A. Stipçeviq, ua kushtoi kërkimet e tij shkencore trashëgimisë kulturore, shpirtërore e gjuhësore të vendlindjes së tij, gjë që është pasqyruar në përmbledhjen me studime "Kultura tradicionale e arbëreshëve të Zarës", Prishtinë 2012, f. 438, një vepër e shkruar me dashuri për vlerat dhe traditën e të parëve të vet. Prof. A. Stipçeviq, ka marrë pjesë aktive në shumë kongrese e konferen-

ca shkencore të zhvilluara në Tiranë e Prishtinë. Në referatin që mbajti në Kuvendin e Dytë të Studimeve Ilire në Tiranë (1985), trajton dhe evidencën praninë e elementit ilir në tërë Ballkanin. Ai arrin në përfundimin se ky përbërës është një substrat etnik, i cili është prezent tek të gjithë popujt e Gadishullit. Ai nuk mund të jetë kurrsesi element përçarës, por element bashkues. A. Stipçeviq në shumë raste u referohet studimeve të kolegëve shqiptarë kur shkruan: "Nga ekspertët të cilët jo që më kanë shërbyer si shembull, por që për mua sot janë me rëndësi të madhe, do të veçoja kolegët e mi shqiptarë: Anmalin, Prendin, Korkutin. Ata janë ekspertë të shkëlqyer dhe miq të mirë, të cilët janë absolutisht në nivelin botëror" (Bota e Re, Prishtinë 1985). Vepra kërkimore shkencore 50-vjeçare e Prof. A. Stipçeviqit për ILIRËT, për arbanasit e Zarës dhe më gjerë, qëndron e denjë e solide si "Gur ciklopik" (gurë masiv te skulptur me lidhje të thatë përdorur në ndërtimin e mureve të qyteteve e qytezave ilire të shek. IV-III p.e.sonë) në historinë e studimeve ilire. Profesor Stipçeviqi vdiq në vitin 2015.



Ese

NDIZNI DRITAT E SHPIRTIT O NJERËZ TË MJERË

Si të gjithë poetët e emigruar dhe Miltiadh i kthehet vendlindjes, ku kujtimet depozitohen tek "Pusi i mallit", si një nevojë kjo për të kompensuar mungesat


Fatbardh AMURSI

"Ndizni dritat e shpirtit, o njerëz të mjerë!"-kjo është thirrja që poeti Miltiadh Davidhi u bën vogëlanëve, meskinëve, jezuitëve, të gjithë atyre, që në një farë kuptimi quhen "forca të errëta". Ti mund të rrish me qiri në dorë, sikurse Diogjeni në kërkim të njeriut, por njeriun së pari duhet ta kesh brenda vetes, ndaj pasojnë vargjet: "Ndale trokun e revanshit tënd". Këtu duhet kuptuar diçka: Konti Monte Kriston s' mund ta akuzosh për revansh, përkundër aktorit mizor, i cili në Lion të Francës nxori ngabodrumigjytin në inkuizicionit duke masakruar vendasit, si hakmarrje pse ata: s' e kishin duartrokatur në shfaqjen ku ai interpretoi. Një dëshmi kjo se deri ku shkon hakmarrja e mediokrit. "O zemrim, që më nxit" e më shtyn/Në urrejtje!/Më fal qetësinë e arsyes,/Më shumë ajër për të thithur/E dritë për të parë/Sytë e të vërtetës." Thirrja kalon në lutje, si e si zemërimi të mos kalojë në urrejtje, sikurse mëkati në faj. Arsyeja pse poeti kërkon të ndizen dritat e shpirtit, veç të tjerave: shfaqet dhe si një nevojë për të parë të vërtetën. (Mediat shtohen, por e vërteta më së shumti fshihet se sa zbulohet.) E

vërteta të kujton mbretin lakuriq, që e shihnin të gjithë, por duhej fëmija, ta tregonte me gisht lakuriqësinë e tij. Kështu ndodh në një shoqëri të zhburrëruar. "Njeriu i padukshëm/Mbete gjithë jetën/I fshehur pas një reje./Pas një drite të bukur në dukje./Ndonëse kurrë s'e kemi parë/Dritën e fytyrës tënde./E aq më pak Tejudkshëmërin' e shpirtit tënd." Sa e sa vriten pa ditur se kush i vret, do thoshte Ayn Rand. Është pikërisht ky i padukshmi, që fshihet pas një aureole "drite të bukur në dukje", duke pretenduar "tejudkshëmërinë e shpirtit", "dritën e fytyrës", shfaqur herë si "shenjtë" e herë si "babaxhan", por, krejt i përngjashëm, me një profil fallco, haker, erini, duke fshehur autorësinë e viktimitave. Ndaj dhe poeti revoltohet: "Të vetëshpallurit poet"/I morën të gjitha çmimet,/Për be asnjë nuk lanë./Ca zhgarravitës të rëndomtë./Që veç poet nuk janë./Ca miq këtej, ca miq matanë/e vetëshpallën veten "mbret"/ca grafomanë të rëndomtë,/që shkruajnë për ibret" (I përkasim një vendi, ku dhe mbreti u vetëshpall. Në kohën e diktaturës u hap një lokal i quajtur "vetëshërbim" deri sa arritëm tek selfiet e sotme.) Poezia për ibret, më kujton shurupët me pluhur kimikatesh, që po tregto-

hej pas viteve 90-të. Për të gjithë këto deti i thotë poetit, që të rebelohet: "Rebelohu, rebelohu, rebelohu, por ki kujdes./Në fillim rebelimin duhet ta fillosh nga vetja." Rebelimi ndaj vetes është gjëja e parë, që duhet të që kërkojnë ndjesë, preferoj atë që reflekton. Këta të ndjesës, përgjithë

sisht pragmatistë, që u pëlqen të pozojnë, më kujtojnë aktorin, i cili luajti në filma heroit pozitiv dhe një ditë u kujtua të kërkonte ndjesë, pse qe kthyer në shembull frymëzimi?! "Njerëzve, s'ua kam fikur me përbuzje/Dritën e dashurisë, tingujt e yjeve i kam dëgjuar/...Dhe ju jam gëzuar sinqerisht shokëve e miqve." Më së



Si të gjithë poetët e emigruar dhe Miltiadhi i kthehet vendlindjes, ku kujtimet depozitohen tek "Pusi i malit", si një nevojë kjo për të kompensuar mungesat. I mbetur në vendlindje, atje, në Krutje, ende e shuan etjen në një pus ngritur prej imagjinatës. "Harruar kam veten,/Në një pemë mani, fiku, kumbulle,/Molle

e hardhie,/Ngecur këmbën në një bigaçe,/E i varur me kokën poshtë/Duke pritur dikush të më shpëtojë." Në këtë rast, bukur do qe, të isha dhe unë në rolin e këtij shpëtimtari. "Të mjerat gjurmë që vdesin/Ende pa u lindur mirë,/Ndonëse pranë detit të kaltër,/Jetojnë nën një qiell të nxirë!" Në rërë s'ka duk një kështjellë e jo më

gjurmët, që lihen në të. Por, kur poezia është e shkruar bukur, ajo lë gjurmë që ç'ke me të. Miltiadhi nuk udhëhiqet nga narcizmi i të dukurit, ku projektorët hidhen nga vetja, i mjafton qiriri i Naim Frashërit dhe llamba e Diogjenit, ngaqë ndërton marrëdhënie realiste me kohën, jetën, artin, miqtë, itërhequr nga ideja për të

lënë një emër të mirë, konvertuar kjo në gjurmë. U përpoqa, që, përjetimet e shpërndara nga leximi i poezive, tregimeve, romanit dhe të asaj pak njohje që kam me autorin, t'i shkar-koja në pusin e kësaj eseje. Pse t'i lija të iknin kot? Dhe, nëse s'kënaqen autorët, fundja i shkruaj për qejfin tim...

Në fokus

KULTURA SI ART DHE IDEJA PËR TË ZËNË VEND NË BOTË

Nuk kemi vendosur as edhe një tullë për më shumë se gjysmë shekulli për kulturën, por kjo është arsyeja pse ndërkohë ne i kthym ndërtesat kulturore në qendra tregtare, sallone bukurie dhe kafene

Nga Metin IZETI

Sociologjia është heterogjene, disa nga pjesët e saj ndodhen midis shkencës dhe artit, e thënë më shpesh midis "metodave sasiore" dhe "cilësore". Robert Nisbet, një sociolog britanik, fliste me përbuzje të konsiderueshme për përpjekjen për të ndërtuar sistematikisht mendimin sociologjik, si një kombinim i hipotezave të përgjithshme dhe testeve empirike, dhe hodhi idenë e sociologjisë si një formë arti që ka një strukturë dramatike narrative të kompletuar apo të reduktuar, në varësi të idesë udhëzuese. Në marksizëm, ideja e fundit e historisë konsiderohej fitorja e proletariatit, pas një lufte të gjatë dhe sfilatës, por kohët e fundit flitet edhe si një gërmadhë e përbashkët (sot duket se jemi më afër kësaj të fundit, e cila është afër "zgjidhjes përfundimtare" të Hitlerit). Në drejtimin tjetër sociologjik, në funksionalizëm, të paktën siç e shoh unë, historia përfundon si një shoqëri që ripërtërihet mbi bazën e një tregu pak a shumë të rregulluar mallrash dhe shërbimesh, në disa mënyra amerikane, ose ndryshe me konflikte dhe luftëra me pauza në të cilat ndërtohej ajo që po shembet (për të shembur sërish). Natyrisht, përveç atyre përfundimeve orwelliane, ka edhe një konglomerat idesh për zhvillimin e qëndrueshëm, (si ai i "Evropës së gjelbër"), të cilin e ka marrë përsipër politika kulturore në shumë vende, përfshirë edhe viset tona. Në përgjithësi, nuk mund të thuhet se kultura kombëtare, nuk merret me këto çështje dhe se prej tyre shqetësohet vetëm biznesi. Të gjithë e kemi parasysh ideja e kombit u krijuan në elitën kulturore, kryesisht në mesin e rilindasve, shpesh në frymën e romantizmit dhe të njëfarë kozmopolitizmi.

Nga politika dhe policia deri te shkollat dhe familjet

Ti kthehem çështjes sonë! Si do ta kuptojmë nëse njerëzit i përmbahen disa vlerave shoqërore, pra nëse na thonë sinqerisht atë që thonë apo

mendojnë? Ka një kurth të dyfishtë në këtë pyetje. Së pari, një numër i madh njerëzish nuk kanë një qëndrim të caktuar ndaj çështjeve të përgjithshme. Dhe së dyti, duhet mbajtur mend se në shoqëri kemi shumë institucione ku mbizotëron hipokrizia. Dhe nuk mendoj se këto janë "vetëm raste individuale" apo pasoja të një politike të keqe të personelit. Çështja është shumë më serioze dhe problemi është i pazgjidhshëm ndoshta që në fillimet e qytetërimeve, shumica e të cilave u rritën në grabitje dhe dhunë me justifikim në ideologjinë apo kozmologjinë e grupit në pushtet. Këtu, si studiues apo pedagogë, kemi dy zgjedhje. Së pari, metoda e anketës, e cila ka një mbulim sipërfaqësor dhe më së shpeshti kemi të bëjmë me konformitet - sepse shumica e njerëzve japin përgjigje të përshtatura, të dëshirueshme shoqërore - duhet të kombinohet me një intervistë të thelluar me një person ose persona nga kampioni i të anketuarve ose, përndryshe, me metodën e vëzhgimit të monitorohet sjellja e këtyre personave në situata të tjera apo më sfiduese, për të përcaktuar se deri në çfarë mase përputhen fjalët dhe veprimet e tyre. Megjithatë, përveç faktit se kombinimi i metodave të kërkimit është shumë i shtrenjtë, është edhe pjesërisht i rrezikshëm, sepse nuk duhet t'i kontrollojmë njerëzit si policët me rroba civile. Kjo është gjithashtu një çështje e rëndësishme etike që doli në plan të parë në mënyrë dramatike në prag të luftërave në ish-Jugosllavi. Është e qartë se në të dyja rastet bëhet fjalë për ambivalencën e shumicës së njerëzve që përpiqen të përshtaten me situatën ekzistuese me një farë ankthi. A janë të furishëm njerëzit në mazhorancë apo sjellja e tyre përcaktohet në mënyrë vendimtare nga institucionet problematike, nga politika dhe policia deri te shkollat dhe familjet? Për të kuptuar më mirë sjelljen shoqërore dhe institucionet sociale, disa sociologë, për shembull Lewis Coser në Amerikë, Ivan Kuvacić në Kroaci, ofruan si zgjidhje që teksti shkollor i sociologjisë të ridizajnohet në

mënyrë që të jetë më afër letërsisë, që çdo koncept kyç të ilustruhet me pasazhe nga letërsia botërore. Kështu, shumë studentë u njohën me konceptin e kulturës për herë të parë përmes fragmenteve nga veprat e Scott Fitzgerald, kontrollit shoqëror përmes Dostojevskit, burokracisë përmes Kafkës, dyfishimit përmes Gogolit etj. Në literaturë, marrëdhëniet shoqërore paraqiten në një mënyrë që nuk është e mundur në analizën empirike të shoqërisë, sepse kjo e fundit duhet të nxitojë në përfundime duke marrë parasysh hipotezat fillestare. Një gjë e tillë në tekstin letrar nuk ka dhe nuk mund të jetë, përveç atij tendencioz, si realizmi socialist, që dukej si një kontrast me ideologjinë sunduese për një periudhë të caktuar kohe.

Fundi i tmerrshëm i modernizmit evropian

Mendja e shëndoshë ose të menduarit e përbashkët për shoqërinë ka një jetëgjatësi më të gjatë, sepse është afër stereotipit social. Nga ana tjetër, ata që nuk mendojnë njësoj, as takohen dhe as flasin, por mbeten brenda disa kornizave fraksionare apo ideologjike. Spektri i ndarjeve të ndryshme në shoqëri që synojnë të përjashtojnë të tjerët nga komunikimi ose shoqërimi është në fakt shumë më i madh. Në këtë spektër në rritje të marrëdhënieve problematike ndaj shoqërisë, sociologjia dhe letërsia prekin pjesërisht njëra-tjetrën duke dekonstruktuar stereotipat shoqërore. Dallimi është se sociologjia e bën këtë përmes kategorive analitike që nuk korrespondojnë kurrë me kategoritë sociale, qoftë kombëtare apo gjinore. E megjithatë, asnjë individ nuk përfaqëson një prototip, një pikë fikse në qëndrime, nuk mendon gjithmonë njësoj apo mesatarisht për gjithçka. Heroina e vërtetë "në viset tona" përfaqëson një iluzion kolektiv, një kukull dhe jo një qenie njerëzore. Heroi i trajtuar me mjeshtëri në letërsi është Don Kishoti i Servantes-it, i cili hapi derën e të gjitha llojeve të analizave të besimeve kole-

tive, nga përshkrimi biblik i Zotit deri tek analiza e liderëve karizmatikë. Falë kësaj, mund të konstatojmë se letërsia dhe sociologjia po punojnë në të njëjtën punë të zbrërthimit të stereotipeve shoqërore, nga mbajtësit e pushtetit e deri te njerëzit që mezi vërehen. Kështu, për shembull, Odiseu i Homerit është një mbret në një komunitet ushtarako-demokratik, por edhe një kapiten tipik deti dhe, "thjesht" një marinar që ankorohet në porte të ndryshme. Odiseu gjithashtu shmang koret femra të Sirenave, një rreth i ngushtë i muzave, sepse ata janë të dy të vërtetë dhe kritikë ndaj perëndive olimpikë si iniciatorë të luftës midis grekëve - në mënyrë që të mund të nxitojë në shtëpi për të përzënë kërkuesit e Penelopës e cila nuk bie në tundime dashurie të ngjashme me të tija. Nga ana tjetër, koloneli i Markezit, Aureliano Buendia, u prek aq shumë nga pamja e verandës së shtëpisë të rindërtuar nga dora e një gruaje të moshuar, Ursula, sa as që mendonte të shkonte në luftë. Ester'i i Pamukut është një amvise hebreje që u shet femrave rroba dhe gjëra të ndryshme dhe në të njëjtën kohë u dërgon letra dashnorëve të tyre. Në fakt, në të shumtën e rasteve, personazhi letrar nuk ka asnjë ngjashmëri me tipat sociologjikë të individëve, për shembull tipi racional ose ndryshe afektiv i Weber-it ose homo duplexi i Marksit përballë proletarit "i cili nuk ka asgjë për të humbur veç prangat e tij", ose romaniku i Simmel-it ("individ egoist") ose gjermanik ("heroik"); kështu që Ester'i i lartpërmendur nuk është si mbretëresha legjendare persiane, e retushuar në mënyrë agresive si shumica e personazheve biblike të ngarkuara me virtyte. Gjithashtu, personazhet negative në letërsi nuk përshtaten në llojet sociologjike të veprimit shoqëror individual ose stereotipeve popullore, për shembull, Shylock Tregtari i Venedikut) i Shekspirit sillet sipas skemës së paragjyqimeve antisemitike. Fatmirësisht, ne që kritikojmë kapitalizmin dhe mash-

trimet tregtare, edhe në luftën aktuale në Evropë, nuk aludojmë se kombësia është vendimtare dhe kemi në krah intelektualë të mëdhenj hebrenj, kritikë të kapitalizmit, nga Marks i Chomsky, për shembull. Nga ana tjetër, Iago i Shekspirit apo Kopranci i Molerit nuk shënohen nga ndonjë identitet i veçantë shoqëror, le të themi proto-anglisht apo proto-francez me stereotipe të lidhura; për shembull eksperimentuesi në rastin e parë ose ai që gënjen në fytyrë në rastin e dytë. Përveç kësaj, Iago nuk i urren njerëzit e skuadrës, sepse duhet të tërheqë shumë me veprimet e tij korrekte dhe të fitojë simpatinë e tyre, sigurisht për arsye manipuluese, dhe pastaj t'i lërë të gjithë në baltë, por edhe ta lënë. Një demagog i vërtetë luan nxehetë e ftohtë dhe rrezikon shumë. Nga ana tjetër, një kopranc ka gjithmonë në mendje të njëjtën gjë, si të fitojë pasuri pa pjesën e tij materiale, pra nuk është sipërmarrës, por është i zoti në përfaqësim të rremë. Kështu ai joshi vajzën e burrit të cilit i grabiti shtëpinë. Pa dyshim, në metodën e tij të përshkrimit të llojeve ideale (të paqarta) të individëve, Max Weber vuri në dukje se në realitet një karakteristikë mbizotëron mbi një tjetër, por jo gjithmonë ose në çdo situatë. Në fakt, ai ishte një modernist i zhgënjyer që i pëlqente të lexonte Faustin e Gëtes, dhe ai, ashtu si Niçe, ishte veçanërisht i interesuar për personazhin e Mefistos dhe përçmimin e tij për risitë, të cilat ai i konsideronte si përpjekje të kota për vetë-lavdërim të njerëzve mashtrues. Kjo, natyrisht, përfshinë edhe afeksionin nacionalist. Çfarë mund të them veç se modernizmi evropian nuk mund të kishte një fund më të tmerrshëm vetëm për shkak të solidaritetit ndërkombëtar, asaj shtrir-

jeje të përbuzur të solidaritetit klastor të punëtorëve, që u bë fiktive.

Kultura thelbi i jetës

Në përgjithësi, mund të konkludohet se kjo është një politikë në hapësirën e ngushtë manovruese të gjysmëpërfunduar evropiane. Nëse e analizojmë "kokën" dhe pjesët tjera të trupit politik, ne, në të vërtetë pyesim veten nëse ka ndodhur shpërbërja e tyre, në aspekt mbarëpolitik dhe shoqëror. Jo të gjitha pjesët e shoqërisë dhe kulturës janë fjalë për fjalë "tonat". Do të doja të përdorja shembëlltë të studiuësit bullgar të skenës kulturore bashkëkohore ballkanike, Aleksandër Kyosev. Ai beson se është një model ekzcentrik i kulturës dhe zhvillimit në përgjithësi, se "koka" është diku në Perëndim, edhe pse as ai nuk është i sigurt se çfarë është ajo kokë, për të mos thënë që ne nuk e kemi kaluar pragun hobbesian, sepse është e vështirë të thuhet se kush i mban realisht lekët e paqes civile të përhershme apo të luftës me ndërprerje më të shkurtra... Kapitalizmi që lindi në Perëndim dhe po udhëton drejt Lindjes dhe Jugut, ka krijuar një bujë të madhe. Në këtë kontekst, kulturat kombëtare bëhen laboratorë dëshirash jorealiste, të djathta apo të majta. Edhe ne me strategjinë e zhvillimit kulturor "shprehëm një dëshirë të tillë" që të paktën të jemi sa më të barabartë në mendimet tona për kulturën dhe zhvillimin. Sigurisht, nëse do të hysh në atë treg, edhe pse nuk është kushti i vetëm, duhet të jetosh dhe të punosh pranë qendrave më të ngarkuara të prodhimit letrar. Megjithatë, shtresimi social global nuk është vendimtar në përfshirjen në elitën kulturore, një dallim bordieuian, edhe pse ai është në elitën politike kur bëhet fjalë për

Çmimet Nobel për Paqe, disa prej të cilave janë politikisht të njëanshme dhe skandaloze. Në rastet e zgjedhjes midis vlerave të barabarta, vlen ajo që Weber e cilësoi si pamatshmërinë e vlerave - nuk mund të matim gjithçka me të njëjtin matës, siç e dimë në fund të fundit nga konkurrenca në kulturë. Një vëzhgim i kohëve të fundit nga sociologjia e kulturës në këtë kuptim vlen edhe për autorët letrarë. Bëhet fjalë për pabarazinë globale mes autorëve nga Bota e Parë dhe e Tretë. Autorët e fundit janë të varur nga vendimet botuese të shtëpive me reputacion nga Parisi, Londra apo Nju Jorku dhe shpesh përjashtohen nga shqyrtimi tashmë në raundin e parë të vendimmarrjes. Prandaj, ata duhet të trokasin në dyert e botuesve më të vegjël me koston e detyrimit për të paguar vetë kostot kryesore të prodhimit, nga shtypja e tekstit dhe korrigjimi deri te pagesa e të drejtës së autorit për përdorimin e burimeve të tjera. Pas kësaj, praktikisht nuk ka më kontakt, pasuar nga raportet e kontabilitetit për një numër relativisht të vogël kopjesh të shitura, sa për të përjashtuar të drejtën e honorareve. Për një kohë të gjatë, ne e jetuam përkufizimin e kulturës si një superstrukturë shoqërore, e cila nënkuptonte idenë se ajo ishte një aktivitet i dorës së dytë. Përkundrazi, kultura është thelbi i jetës, do të thojta. Kultura është diçka që na orienton në dikotominë e Frommit 'të kesh ose të jesh'. Kultura na çon drejt të menduarit, inteligjencës dhe ndjenjave dhe e gjithë kjo e largon njeriun nga ajo që, për fat të keq, është shumë dominuese në këto kohë, që është nevoja për të zotëruar. Nevoja për të zotëruar është një nevojë dytësore ndaj nevojës për të jetuar. Është kultura ajo që na orienton dhe

na drejton në atë drejtim. Prandaj na duhet. Ndjenja e lirisë mund të fitohet përmes kulturës. Ndjenja e lirisë mund të fitohet përmes një nervi artistik. Një ndjenjë lirie mund të fitohet përmes vetëbesimit. Nuk kemi vetëbesim, nuk kemi liri të plotë, nuk kemi nerv artistik. Ai nervi artistik, nëse e kuptojnë njerëzit që kanë njohuri dhe arsimit të mjaftueshëm, do të krijojnë një mikrob rebelimi që duhet të shfaqet. Unë besoj në artin dhe kulturën, të cilat, si një sondë, duhet të depërtojnë thellë në brendësi të qenies sonë dhe ta portretizojnë atë nga këndvështrime të ndryshme. Të ndezim dritën në ato dhoma që mendojmë se janë të errëta dhe të humbura përgjithmonë. Pastaj i kujtojmë ato vepra. Ato vepra pastaj bëhen trashëgimia jonë kulturore dhe historike, bëhen pikat tona identitare. Në këtë kuptim, mendoj se kjo kulturë e sotme, është e komercializuar në masë të madhe, e mbështetur nga një elitë e sapokrijuar në shoqërinë tonë, e cila më parë nuk kishte qenë asnjëherë spektatore e asnjë ngjarjeje të kulturës së lartë kritike. Atëherë e keni të qartë se çfarë po konsumohet në të vërtetë, çfarë po ndodh, dhe nëse do ta transferoja në sferën e arkitekturës - thonë se arkitektura është muzikë e ngurtësuar, kështu tha Gaudi - atëherë do të dukej kështu: ne nuk kemi vendosur as edhe një tullë për më shumë se gjysmë shekulli për kulturën, por kjo është arsyeja pse ndërkohë ne i kthym ndërtesat kulturore në qendra tregtare, sallone bukurie dhe kafene. Kjo është politika në kuptimin urbanistik në kontekst të shoqërisë tonë dhe fatkeqësisht e njëjta është edhe në kuptimin shpirtëror.



Shënime mbi krijimtarinë e Agim Bajramit


REFLEKSIONE PËRTEJ

NJË KOPERTINE LETRARE

Poezia është pjesa më nazike e letërsisë dhe Agim Bajrami e ka kapur Pegasin aty ku duhet, me qetësinë e tij tashmë proverbiale, me vrullin rinor, me guximin që frymëzon poezitë e tij, sidomos kohët e fundit

Fatmir MINGULI

Ishte pikërisht një takim i stafit të studios 2M me shkrimtarë të Sarandës kur poeti dhe tregimtari Hekuran Halili na foli me mjaft entuziazëm për poetin Agim Bajrami. Se mos vetëm ai. Në takime të ndryshme, emrin e tij do ta përmendim shkrimtari i Malit të Zi, Dimitrov Popoviç, vetë Sulejman Mato si dhe shkrimtari Arben Kondi gjatë një konference shkencore në Pejë. Këto janë vetëm disa takime të rastësishme, por ajo që është më e rëndësishmja, është jehona që ky poet e ka tashmë pjesë të jetës së tij. Poezia është pjesa më nazike e letërsisë dhe Agim Bajrami e ka kapur Pegasin aty ku duhet, me qetësinë e tij tashmë proverbiale, me vrullin rinor, me guximin që frymëzon poezitë e tij, sidomos kohët e fundit. Me të drejtë, studiuesi durrsak, Pol Milo, konstaton që shumë poezi të postuara nga Agim Bajrami, se ç'kanë disa tingëllima ndryshe, si një jehonë përsëritëse që vjen në ngritje, një melodi e fshehur në zemrën e vargjeve. Tingëllimat e tij janë si notat e një kënge që rrezaton një ndjesi duke shpërfaqur thellësinë dhe pasionin e shpirtit. Ky vështrim poetik me nota respekti dhe admirimi është një muzikalitet i shpirtit që prek dhe mbetet në mendjen e lexuesit. Por, le të kthehemi te magjia që një kopertinë reviste letrare të sjell në qenien tënde e për aq më tepër kur është fjala për një portret tejet të njohur, të një bashkëqytetari të Durrësit, të një poeti që ka vite që përcjell me vargjet e tij jetën urbane të këtij qyteti. Por kopertina flet më shumë se sa shumë fjalë që mund të shkruajmë, sepse vetë ajo ka forcën sugjestionuese dhe të çon në mendimet e cilat nuk janë më mendime por skica për ese apo proza të shkurtra. Kjo kopertinë me portretin e Agimit nuk është rastësi. Ajo vjen mbas botimit të dhjetëra shkrimeve që Agim Bajrami ka përcjellë idetë e veta mbi letërsinë në faqet e revistës letrare "Hejza" që në numrin e saj të parë. Nuk është rastësi, sepse poezitë e Agim Bajramit i kanë kaluar kufijtë e Shqipërisë dhe tashmë unë do ta quaja poetin e trojeve shqiptare, falë famës që vetë poezia ia ka dhënë. E tillë është dhe kopertina e revistës elektronike prestigjioze HEJZA. Shkrimet kritike të botuara jo vetëm te kjo revistë të Agim Bajramit kanë historinë e tyre, histori që filloi me botimin e librit me kritika letrare "Kthimi i gjeneralit" në vitin 2017 dhe që vazhdoi me botime në gazetën nacionale të Tiranës, Shkupit, Prishtinës. Duke krijuar këtë fizionomi të re, Agimi tregohet një poet i vërtetë edhe në



shkrimet kritike, duke sjellë një frymë të re në mënyrën e të shkruarit, një mënyrë ku brenda rreshtave regëtojnë filiza të poezive, që në fund të shkrimit gonxhja ka dalë me madhësinë e lules dhe kritika nuk është më kritikë, por një buqetë me mendime të freskëta dhe të këndshme, pra që nuk të mërzisin. Kështu është dhe intervista e botuar në HEJZA ku Agim Bajrami me një qartësi të kthjellët jep mendimet e veta edhe kur pyetjet në këtë intervistë janë disi të vështira. Ai ka koncepte të drejta për një letërsi kombëtare kur thotë se "ajo është hallka që di të bëjë lidhjet mes të shkruarës dhe të sotmes, duke parë më qartë se të tjerët me syrin e saj vizionar të ardhmen". Ai kritikon me të drejtë institucionet përgjegjëse të shteteve përkatëse që nuk kanë strategjinë e një unifikimi në formastandardet e letërsisë kombëtare. Agimi pasi jep disa shembuj me emra shkrimtarësh të huaj dhe shqiptarësh që kanë realizuar letërsi kombëtare. Ai i bën skanerin disa antologjive poetike që nuk dalin dot nga kufijtë e provincialitetit apo siç e quan intervistuesi Shkëlzen Halimi, "kufijtë e mëhallës". Nuk është e thënë që në këto shënime të bëjmë anamnezën e kësaj interviste, por ajo që duhet theksuar

është konstatimi me eksperiencë vetjake, qoftë për problemet e financimit me sponsorizime të botimit të veprave letrare, qoftë organizimet nga organet ministrare të konkurseve, apo tubimeve kombëtare, apo edhe mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Kjo intervistë ka vlerat e një studimi shumë planesh, një lloj abstrakti për një zhvillim të mëtejshëm të ideve të shprehura aty. Poeti Agim Bajrami me poezitë e tij, po arrin caqe të pamenduara. Sot, ai jo vetëm si poet i Durrësit, por mbarë kombëtar, jo vetëm si poet me origjinë çame, po poet i Shqipërisë, ka ndërtuar kështjellën e tij të kristaltë poetike. Me një përfrazim metaforik do të thoja se Agim Bajrami është si mjeku Norman Bety, mjek i tre kontinenteve dhe Agimi tashmë është poet i njohur në tre shtete Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, që me poezitë e tij shëron shpirtat njerëzorë. Si pak kush i ka dhënë poezisë një pelerinë transparente, ku metaforat dhe maksimat marrin jetë formë, e reflektimi i tyre i ndryshon ngjyrat vargjeve magjishëm. Me këtë rast të këtyre shënimeve po sjell disa nga komentet që kam bërë për disa poezi të fundit të Agimit, të postuara në faqet e mediave letrare.

Për poezinë "Mesditë në ikje", kam shkruar se "Bota e shqetësuar e poetit përmes metaforës dhimbse të ikjes së mesditës, pra ikjes së vetë ditës, është dhënë me ngjyra bodleriane, është një poezi që nderon madhësinë e poetikës së Agim Bajramit." Dielli, simbol i jetës dhe energjisë, bie në hije për t'u mbuluar nga këto ndjenja të errëta dhe të thella, ndërsa neonet, simbole të dritës moderne, duket se janë të ndjeshme ndaj shpirtit të trishtuar. Ja disa strofa të kësaj poezie: *Seç ka një panik këto çaste Tek pemët që drithërojnë në erë Konturet e tyre, pas pak do të shkrihen Si gjithë anonimet e mjerë.*

Mjafton veç kaq, që ato të trishtohen Mërzia t'iu ulet mbi sy Ato janë krijuar me diell të mbulohen Neonet i kanë alergji

Këto çaste si ato dhe unë

Do hyj mes territ pak nga pak Afrimi i natës mbjell kaq dhunë Në trup, mendime dhe në gjak.

Ndërsa në poezinë "Gosti maskarenjsh", që ka marrë karakter të theksuar socio-politik, ka një varg grotesk, por nga mesazhi që ai sjell nuk duket më i tillë. Në poezinë "Vetmi perme", ka ditur të skicojë botën e vetmisë së njeriut përmes vetmisë së pemës, ku e quan si një skenë lëvizëse të ekzistencës së njeriut. Edhe sikur kjo poezi të jetë ese apo skicë poetike nuk do të mundte të shpaloste tërësisht huret e poezisë së tij. Këtu bashkohem me komentin e Pol Milos, i cili thotë se: "kjo është një skenë lëvizëse e një transformizmi përherë e në perfeksion, si dhunti nga universi." Në poezinë me titullin shekspirian "Ofeli!" paralelja me heroinën e mesjetës është dhunti poetëve të fuqishëm ku empatia e poetit e zbërthen atë që të tjerët nuk e kapin dot, atë të keqe të partnerit të Ofelisë engjell shqiptar. Po imbyll këto shënime me një koment përpoezinë "Ndonjëherë", e cila shquhet për një ekzistencializëm të veçantë, i cili rrezaton jo vetëm me poezi:

Ndonjëherë më ndodhin ca gjëra të çuditshme

Dashurohem me lulet, por gjithmonë u rri larg

Të gjithë dashuritë mbajnë aromën e tyre Dhe aroma të tilla, jo kushdo i ka hak.

Simboli i filozofisë së jetës, përbën një pjesë të rëndësishme të zhvillimit personal dhe shpirtëror. Nëpërmjet këtij procesi, poezia jep një mesazh të fuqishëm për vlerën e përmirësimit personal dhe gjetjen e paqes nëpërmjet vullnetit të brendshëm dhe përkushtimit ndaj vetes. Aroma është privilegji i atyre që kanë kuptuar thelbin e vargut të jetës, një përgjigje ndaj thirrjes së fshehtë që vjen nga zemra. Nga ana ime, kjo është vetëm një përjasje fillestare për ekzistencializmin e tij poetik, por e ardhmja është pranë!

Në kujtim të Frederik Rreshpjes

POETI ME SHTAT TË VOGËL

Veçanërisht vitet e fundit, në konceptin filozofik e poetik të krijuesit Frederik Rreshpja, metafora e VETMISË u bë domethënëse dhe e dukshme, gjalluese, ripërtëritëse, duke u bërë lajtmotiv i krijimtarisë së tij, siç ishte edhe lajtmotiv i jetës së Fredit


Khahid BUSHATI

Kam filluar ta kujtoj më shpesh Frederikun ose Fredin, siç e thërrisnim për shkurt. Kujtoj at' rrugicë që mbante emrin e patriotit Dedë Gjo' Luli. Jam kthyer shumë herë, e shumë herë do të kthehem, e do të kthehem, aty. Hera ime e parë ka qenë, kur isha gjimnazist. Ajo rrugicë ka fiksuar në kujtesë ecjen e shpejtë e pa zhurmë, shpesh vetmitare të Fredit. Ajo ecje, si një gjurmë poetike, mbarte në vetvete kontrastin mes njohjes dhe mosnjohjes së këtij njeriu me shtat të vogël e të mençur, nga banorët e kësaj rrugice. Mbarte deri diku edhe indiferencën e tyre për komshiuin e heshtur. Nuk e di pse kjo frazë më kujtoi psikologjinë e mentalitetin e amullt, të mbylljes në vetvete e të asaj 'matanë murit', të shumë personazheve të tregimeve realiste e moderne, të trishtuar dhe ekzistencialë të E. Koliqit për Shkodrën dhe mjedisin e saj me gjithë nënshtrës, që i njohu aq mirë. Bota e Frederikut, nuk përkonte me 'botën' e lagjes ku banonte. Planeti i tij poetik, edhe pse shpesh i përjashtuar, tharmin, thelbin e tij e kishte 'Në këtë rrugicë...', ku Fredi me përlësi dhe nderim kishte vënë shpirtin e vet si një gur qendresë, lavdie e jetese, e më vonë si muranë. Kishte vënë lirikën si dëshmi, tregimet, legjendat dhe përrallat si ëndrra magjiplote. Ai me talentin dhe personalitetin e tij të spikatur po i shtonte gjurmët e vlerës rrugicës së tij të dashur. Është një rrugicë-muze. Rrugicë-plot histori, ku personalitete të fuqishme, gjurmë të thella lanë aty. Është një rrugicë, që në të shkuarën

e largët të saj kishte fiksuar gjurmët e atdhetarit, poetit e dramaturgut Hilë Mosi, i cili pati mbjellë aty, shumë e shumë vite më parë, një shegë për djalin e tij të vdekur. Historia e tij, akti i tij na kujton motivin e dhimbshëm të baladave të moçme, ku vdekja animizohet përmes një simboli, ku personazhi bëhet i gjallë dhe i përjetshëm. Është një rrugicë, ku shkeli e la gjurmët e tij personaliteti i shquar poliedrik, piktori, arkitekti, fotografi... Kolë Idromeno. Gjurmët e kësaj rrugice, janë pjesë e lavdishme e historisë së kulturës së vendit tonë. ... e pikërisht në këtë rrugicë shëtit, u mbrujt dhe lulëzoi fëmijëria e më pas personaliteti i Frederikut. Ishte një fëmijëri e vështirë, por me një përkujdesje të ëmbël mëmësie. Ishte një fëmijëri brenda mureve të gurta të asaj rrugice, ku lulëzonin e gjallonin kopshte trëndafilash. Ishte kjo rrugicë dhe fëmijëria, që do të linin gjurmë të pashlyeshme në kujtesën dhe shpirtin e tij, të cilat do të përbënin më pas kodet e poezisë së Fredit. Ishte fëmijëria në këtë rrugicë, me një botë plot ëndrra, ku edhe 'ngjyrat ishin shpirta', siç shprehej Fredi, për të cilat poeti trishtohej e qante, vetmohej dhe ndiente mall, se ishte fëmijëri e "vizatuar" përmes ngjyrave të trëndafilave, të pëllumbit, të lotit të nënës e të harresës. Në kontekstin poetik simbolika e trëndafilatit lë "shenjën" më të thellë, shenjën më të spikatur, aq sa bëhet personazh i poezisë së tij, kthehet në simbol. Po në këtë kontekst, në të shumtën e herës humbet përftesa e elementit zbukurues, si kuptim i parë etimologjik. Kështu që, prej tij përfitojmë rrjedha të tjera, e të tjera ngjyrimë.

Nga i gjithë cikli me poezi, "rrënjën" e ruan ajo me titull "Trëndafilat e fëmijërisë". Veç shpirtëzimit të fëmijërisë së autorit, jetesa e tyre bëhet e mundur në saje të lidhjes ngushtësisht me mitiken. Ato sjellin në mënyrë biblike një modelim përrallor, të cilin e gjejmë si truall në krijimet dhe në kujtesën popullore. Autori shkon më tej. E shenjtëron, duke pohuar: "Në fund të kopshtit banonte mitologjia / në një Olimp prej trëndafilash." Kjo figurë gjatë gjithë ciklit përfaqësohet në dy mënyra: a) përdorimi i njëjësit për shumësin për t'i dhënë më shumë frymëmarrje, dhe b) përdorimi i shumësit për njëjës për t'i dhënë konkretësi. Si në rastin e parë, ashtu edhe në rastin e dytë, raportet e konkretes me abstrakten sjellin dhe ruajnë imazhe e përfytyrime ireale. Spektri i krahasimeve, me objekt të vetëm dhe në qendër trëndafilin, (që nga psherëtimat, e deri te drurët e vdekur) nuk është gjë tjetër veçse vibracion i gjendjes shpirtërore të Fredit. Në finale, pasi ka mbaratur gjatë gjithë "udhës" përjetime poetike, mendoj se nuk bën gjë tjetër veçse përvijon dukshëm elemente të profilit të tij. E thellon atë. Në komunikimin artistik, këtë gjendje emocionale, këto akuarele nga bota floreale, i ruajnë dhe i shprehin "me fanatizëm" e bukurri të rrallë faqe të tëra të romanit "Zëri i largët i kasolles". Një roman që është i dallueshëm në letërsinë tonë shqipe për tiparet e një proze poetike. Një roman që kritika letrare pati shumë ngurrime dhe nuk ishte aspak entuziaste në gjykimet e saj. Zakonisht kështu ndodh prej këtyre soj dogmash, të cilat në mënyrë diktatoriale e të sforcuar i

krijoi metoda e realizmit socialist. Nuk gaboj po të them se poezia e Fredit lulëzoi së pari te ai gjelbërim spontan që shfaqej në oborrin e tij, gjelbërim që i ngjante një mrekullie të pashoqe. Kjo mrekulli i ngjante një pikturë surreale, veçanërisht netëve kur hëna vinte mike e hidhte rrezet e saj lodërtare. Kjo mrekulli kishte "çelur" edhe në shpirtin e Fredit dhe ruhej po e tillë në lirizmin e poezisë së tij. Lulëzoi edhe te ato trëndafilat, që u bënë metafora ëndrrash e dhembjesh, heshtjesh e pikëllimesh. Çelën, lulëzuan e kurrë s'u thanë në vetminë poetike të Fredit; u dha jetë talenti i tij. Jo më kot "Në pjesën dërmuese të vargjeve të lirikave të Frederik Rreshpjes, jepet një dramë e brendshme përvëluese. Lirizmi i këtij poeti rrëshqet prore brigjeve të revoltës. Poezia e tij është përplot shqetësime, shqetësime të mëdha që buronin nga përditshmëria e jetës së tij. Vargjet e lirikave të Rreshpjes rrëfejnë botën e tij personale, me ngarkesa shqetësuese shpirtërore. Duke gjurmuar finesat e artit të Rreshpjes, pahetueshëm rrëshqasin në të dhënat e tij jetëshkrimore, që përbëjnë këpujën lidhëse: krijuesi-vepra e tij." Veçanërisht vitet e fundit, në konceptin filozofik e poetik të krijuesit Frederik Rreshpja, metafora e VETMISË u bë domethënëse dhe e dukshme, gjalluese, ripërtëritëse, duke u bërë lajtmotiv i krijimtarisë së tij, siç ishte edhe lajtmotiv i jetës së Fredit. Shpërfaqja e tij e plotë u duk në vëllimet e fundit poetike "Në vetmi" e "Vetmi", vëllime që i ngjajnë një testamenti lamtumire, që në fakt është një gur i çmuar dhe i rrallë në fondin e lirikës shqiptare. (Shkodër, shtator 2019)



E shkruar dikur, aktuale dhe sot

VAJTIM PËR LIBRIN SHQIP OSE KULTURA E MOSLEXIMIT

“Një libër i hapur është një mendje që flet; një libër i mbyllur është një mik që pret; një libër i harruar është një shpirt që fal; një libër i shkatërruar është një zemër që qan” (Rabindranat Tagora)

Agim VINCA

Rënia e sistemit komunist e çliroi letërsinë shqipe nga diktati e censura, por e vuri para sfidash të reja. Tok me sistemin e vjetër ra edhe doktrina e realizmit socialist e instaluar prej tij, me çka letërsisë shqipe, në tërësinë e saj, iu bë i mundur zhvillimi i lirë mbi bazën e pluralizmit estetik. U demonopolizua veprimtaria botuese dhe u rehabilituan krijuesit e ndaluar; u zgjerua harta e vlerave edhe me veprën e këtyre të fundit, të gjallë e të vdekur, gjë që mund të quhet një arritje e kulturës sonë në fillimet e pluralizmit. Por, ekonomia e tregut, në njërin anë dhe rrënimet e mekanizmave vlerësues, në anën tjetër, krijoi mundësinë që gjithkush që kishte para ose edhe një status të caktuar shoqëror të mund të botonte libra, edhe atëherë kur ato nuk i plotësonin as kriteret minimale letrare, estetike, gjuhësore e të tjera. Pas një periudhe fashe në fillim të viteve nëntëdhjetë dhe kah mesi i kësaj dekade për mungesë letre e normaliteti në Shqipëri, kurse në Kosovë për shkak të apartheidit serb, i cili nuk i kursente as njerëzit e as librat, gradualisht u normalizua veprimtaria botuese në gjuhën shqipe, kurse letërsia shqipe, falë prurjeve të reja, si të krijuesve të afirmuar, ashtu edhe të rinjve që dolën në skenë ndërkohë, nisi ta marrë veten dhe ta zërë hapin me letërsinë e tjera në rajon dhe, deri diku, edhe në botë. Mirëpo, letërsia, në sistemin e ri të vlerave, që e dikton shoqëria e konsumit, nuk e ka më statusin e dikurshëm dhe nuk është tërheqëse si më parë, kur leximi i veprave letrare, si në poezi, ashtu edhe në prozë dhe veçanërisht i romaneve, ishte një nga kënaqësitë më të mëdha për lexuesin shqiptar. Tirazhi i veprave letrare në gjuhën shqipe sot është i vogël. Rëndom ai sillet te 500 kopje, në mos edhe më pak. Edhe veprat e shkrimtarit më të njohur, më të përkthyer dhe më të lexuar bashkëkohor shqiptar, Ismail Kadaresë, botohen në 1000 kopje. Në disa syresh, madje, mbase mu për këtë arsye, tirazhi nuk figuron fare (shembull: romani Aksidenti dhe libri eseistik Mosmarrëveshja). Ka ikur koha kur romanet e këtij shkrimtari botoheshin me tirazh prej 25 mijë kopjesh, siç ndodhte, fjala vjen, me romanin

Dimri i vetmisë së madhe (1973) dhe shiteshin brenda pak ditësh ose shumë-shumë brenda javës. Kurse rrëfimet për pritje në rend para librarisë për të shtënë në dorë një libër letrar, sot duken si përralla me marsianë. Nga librat që autori i këtyre rreshtave ka pasur në dorë në kohë të fundit vetëm dy arrijnë shifrën rekorde prej dhjetë mijë kopjesh: libri auto-biografik i biznesmenit dhe politikantit Behgjet Pacolli: Nga sfida në sfidë, një jetë (2010) dhe libri i publicistit Bedri Islami kushtuar një figure politike, kryetarit të një partie politike, të Bashkimit Demokratik për Integritet (BDI), zotit Ali Ahmeti, me titull: Ali Ahmeti si e njoha unë ose I vërteti, i shkruar pas aferës së dosjeve në Maqedoni dhe i botuar (e promovuar) në prag të zgjedhjeve më të reja parlamentare në këtë vend. Për hir të së vërtetës duhet thënë se ka pasur edhe vepra letrare që në këto vite janë bërë “bestseller”, natyrisht në rrethana shqiptare, si proza Preja e një martese të lodhur (2003) e Rudina Xhungës dhe romani Të jetosh në ishull (2008) i Ben Blushit, por zhvillimet e mëvonshme treguan se këto vepra famën e tyre, më parë sesa vlerës artistike, ia detyrojnë mbështetjes mediale të mediale të fuqishme elektronike të Tiranës. Tirazhi i veprave letrare në gjuhën shqipe është i vogël; një pjesë e autorëve ua shpërndajnë falas atë miqve dhe të njohurve ose u mbeten në raftet nëpër shtëpitë e tyre, kurse librat me poezi, me pak përjashtime, as që pranojnë t’i tregtojnë pronarët e librave për shkak të interesimit të vogël të lexuesve. Dhe është e çuditshme që numri i studentëve dhe i universiteteve, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë e në Maqedoni, rritet nga dita në ditë, kurse numri i lexuesve dhe i konsumuesve të librit bie vazhdimisht. Një kolumnist shqiptar nga Shkupi, që është njëkohësisht edhe shkrimtar (nuk është Kim Mehmeti, por Shkëlzen Halimi), shkroi kohë më parë: “Sikur vetëm një për qind e atyre që kanë tituj të magjistrave dhe doktorëve t’i vizitonin libraritë edhe ashtu të pakta, me siguri botuesit tanë nuk do të ankoheshin për pozitën e rëndë të librit shqip”. Nuk e di si qëndron puna te popujt e tjerë që janë në tranzicion (një tranzicion i stërzgatur, që s’ishihet fundi), por

te ne shqiptarët aktualisht është shumë më i madh numri i atyre që shkruajnë libra sesa i atyre që lexojnë libra, kurse universitetet tona më shumë se kuadro të afta, të pajisura me dije e kulturë, prodhojnë analfabetë me diplomë. Qasja e këtyre arsimit shqip, shkollës shqipe dhe kulturës shqiptare mund të duket e zyrtë dhe pesimiste, por shpallja e së vërtetës dhe diagnoza e saktë e sëmundjes është gjithmonë më produktive sesa fshehja dhe zbulimi i së vërtetës, siç veprojnë ata që duan t’i mashtrojnë njerëzit dhe t’i arsyetojnë dështimet e veta individuale e kolektive. Letërsia shqipe sot, sikurse edhe në të kaluarën, vazhdon të krijojë në kontekste të ndryshme politike e kulturore, por, ndryshe nga ç’ndodhte dikur, duke përjashtuar pjesërisht periudhën e viteve ‘70, sot është bërë realitet ëndrra e qarkullimit të lirë të njerëzve, librave dhe ideve në relacionin: Prishtinë-Tiranë dhe anasjelltas. Kanë rënë barrierat ideologjike dhe kontrolli i vjetër i kufijve, por hapësira kulturore shqiptare ende nuk funksionon si një e tërë dhe e përbashkët. Është krijuar mundësia e botimit dhe e shkëmbimit të librave, por mungojnë revistat e përbashkëta letrare e kulturore, manifestimet letrare me karakter mbarëkombëtar, projektet e përbashkëta të prezantimit të letërsisë shqipe në botë dhe nisma të tjera të ngjashme me interes për letërsinë dhe kulturën kombëtare. Për integritet shqiptarë flitet vazhdimisht në mënyrë verbale, por pak është bërë konkretisht në këtë plan, si në Prishtinë, ashtu edhe në Tiranë, për të mos thënë se herë-herë bëhen veprime që çojnë në drejtim të kundërt. (Ndoqa këto ditë në TV Klan një emision për poezinë. Gjatë dy orëve e gjysmë, sa zgjati emisioni, nuk u përmend asnjë emër poeti jashtë territorit të Shqipërisë shtetërore: gjithçka sillej brenda atyre 28 mijë kilometrave famoze, shumë më keq se në kohën e komunizmit. Madje fitohej përshtypja se të ftuarve në studion e TV Klanit as që u shkante në mend se letërsia shqipe është krijuar dhe krijohet edhe jashtë kufijve të Shqipërisë së cunuar. Asnjë emër poeti, asnjë libër, asnjë vjershë, asnjë varg; asgjë për farë, jashtë territorit të asaj që quhet Republika e Shqipërisë! E ishin ftuar

për të biseduar në temën “Të jesh poet” poetë të njohur, dhe poetesha, gjithsej gjashtë, plus moderatori i emisionit, që edhe vetë merret me letërsi. Televizioni i fuqishëm “Klan” nuk e kishte parë të udhës të ftonte qoftë edhe një krijues të vetëm nga Kosova a Maqedonia në emisionin në të cilin flitej për letërsinë kombëtare! Që të mos më zihet për të madhe se po bëj vërejtje të njëanshme, në kuptimin politik të fjalës, po shtoj sakaq se edhe emisioni për librat e rinj, që emetohet çdo të diel në “Top-Channel”, ngrihet mbi të njëjtin koncept: shtetëror e jo kombëtar. Në morinë e fytyrave të shkrimtarëve që shfaqen në “shpicën” e emisionit “Libri i ri” të Top-it të dielave në mbrëmje (që edhe ashtu është e pashije), nuk shihet portreti i asnjë shkrimtari jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë. Dhe sikur të mos mjaftonte “shpica”, edhe gjatë emisionit shumë rrallë ndodh, për të mos thënë fare, të paraqitet ndonjë libër i botuar në Prishtinë, në Shkup, në Tetovë, në Ulqin a gjetiu ku jetojnë e krijojnë shqiptarët). Për çka flasin shembujt e mësipërm: për mungesë vetëdijësie mbi ekzistimin e një kulture unike kombëtare; për inerci nga e kaluara apo për nënçmim të vlerave të krijuara jashtë kufijve administrative të “shtetit amë”, në “diasporë”, siç thuhet shpesh gabimisht edhe kur flitet për shqiptarët që jetojnë në trojet e tyre etnike e jo vetëm në botën e jashtme. Sido që të jetë, për të gjitha ngapak apo për secilën veç e veç, dukuritë e këtylla ndikojnë negativisht te njerëzit që e duan dhe përpiqen me gjithë zemër për bashkimin e kombit të ndarë shqiptar, qoftë edhe në planin shpirtëror dhe i “inkurajojnë” ithtarët e të ashtuquajturit “identitet të ri kosovar”, duke u dhënë një “argument” më shumë për ta vazhduar turrin e tyre të marrë kundërhistorik të krijimit të kombit të shpifur “kosovar” dhe, rrjedhimisht, edhe të dy gjuhëve e kulturave kombëtare. Është për t’u habitur fakti që këtë tezë e mbrojnë të shumtën e herëve mu ata që në vitet ‘80, kur zhvillohej fushata e egër kundër kulturës shqiptare dhe “propagandës nga Shqipëria fqinje”, angazheshin për krijimin e hapësirës së përbashkët kulturore jugosllave, përfshirë edhe kulturën shqiptare

dhe "propagandës nga Shqipëria fqinje", angazhoheshin për krijimin e hapësirës së përbashkët kulturore jugosllave, përfshirë edhe kulturën shqiptare që krijohet në ish-Jugosllavi, sepse, "duhet të nisemi nga ajo që na bashkon e jo nga ato na ndajnë", arsyetonin ideologët e "hapësirës së përbashkët kulturore jugosllave", që gjenin shumë pika të përbashkëta me Beogradin atëbotë, kurse nuk gjejnë të tilla me Tiranën sot! Bëra dy vërejtje qëllimmira për dy nga mediat më të rëndësishme shqiptare të kohës sonë, televizionet "Klan" dhe "Top-Channel", në lidhje me dy emisione konkrete, por, për hir të së vërtetës duhet thënë se mediat dhe posaçërisht ato elektronike, kanë bërë një punë të madhe në afrimin dhe njohjen e shqiptarëve në të dy anët e kufirit, madje më shumë se universitetet, katedrat e letërsisë, shoqatat e shkrimtarëve, institutet shkencore etj. Mund të thuhet, madje, se televizionet shqiptare, kanë bërë më shumë se institucionet shtetërore të Shqipërisë dhe të Kosovës bashkë në integrimin e shqiptarëve si komb. Rasti i Italisë, sipas Umberto Ekos, tregon se ky fenomen ka ndodhur shumë kohë më parë edhe me popujt e tjerë. Në një intervistë dhënë gazetës franceze "Le Monde" me rastin e 150-vjetorit të bashkimit të Italisë, shkrimtari dhe semiologu i njohur theksonte rolin e madh të televizionit italian në afrimin e dallimeve gjuhësore e të tjera mes Jugut dhe Veriut. Duke filluar sidomos nga fundi i viteve '50 të shekullit të kaluar, televizioni luajti, sipas Ekos, një rol të rëndësishëm në përhapjen dhe konsolidimin e gjuhës së përbashkët letrare italiane. Falë TV-së, edhe kryeministri problematik italian, Berlusconi, thotë Eko, e flet mirë italishten, kurse polici e taksisti i thjeshtë, shton, "mund të më njohin me të parën". Por roli i televizionit në shoqërinë e sotme është ambivalent: emancipues dhe akulturues njëkohësisht. Sepse ai i largon njerëzit nga libri dhe i bën rob të ekranit, që pasivizon mendjen e njeriut dhe degradon vlerat. E njëjta gjë mund të thuhet pak a shumë edhe për internetin, njëerën nga shpikjet më të mëdha të kohës sonë, që po ashtu ka përparësitë dhe dobësitë e veta. Prozatori i talentuar shqiptar nga Shkodra, Ridvan Dibra, shkroi kohë më parë: "Libri në koma. Rroftë Facebook-u!". Libri klasik, i shtypur në letër, me shkronja tipash e madhësish të ndryshme dhe i lidhur mes dy kopertinash, të forta a të buta, po rrezikohet gjithnjë e më shumë nga komunikimi virtual. Lartmadhëria e tij, Interneti, është bërë si një sirenë bashkëkohore, tundimit të të cilit nuk mund t'i rezistojë askush. Letërsia po e humbet karakterin e saj elitare, kurse puna krijuese po bëhet gjithnjë e më shumë çështje private. Pozitën e shkrimtarit shqiptar sot, vetminë dhe braktisjen e tij, e ka shprehur më së miri, nëpërmjet një parabole interesante, poeti Anton Papeleka në parathënien e librit të tij me poezi Udhëhumbur (2000). E kam cituar edhe një herë tjetër këtë tekst, prandaj po e jap në mënyrë paksa të shkurtuar. "Duke vrarë mendjen për gjendjen time pa rrugëdalje një ditë m'u kujtuan barinjët e vendlindjes (...). Në bjeshkët e larta, në vetmi (...), befasi ndaleshin diku dhe sokëllinin sa u hante zëri. Ai vrushkull tingujsh (...), i ngjante një pasthirmë, por nuk ishte një pasthirmë e zakonshme. Sokëllima e tyre nuk i drejtohej ndonjë njeriu konkret. Ata nuk shpresonin që atë ta dëgjonte ndokush. Ca më pak, që të merrnin përgjigje. Ata sokëllinin për veten e tyre. Ishte një reagim instinktiv kundër vetmisë, kundër izolimit. Me sokëllimat e tyre, ata (...), donin ta bindnin veten se gjallonin diku. Donin të sfidonin, në një farë mënyre, vetminë dhe shurdhërinë që i rrethonte". Një reagim instinktiv kundër vetmisë dhe izolimit; një "klithmë ekzistenciale". Kjo është poezia e kohës sonë. Një mënyrë për të sfiduar vetminë dhe shurdhërinë që na rrethon. Mbase një iluzion. Si pasojë e zhvillimeve socio-kulturore dhe tekniko-teknologjike, letërsia nuk e luan më rolin që kishte dikur në jetën e njerëzve dhe në gjirin e shoqërisë, kurse kultura shqiptare ballafaqohet me disa probleme specifike, që dolën nga kutia e Pandorës në periudhën postkomuniste. Është shqetësues fakti që në emër të lirisë së mendimit, të rishikimit të së kaluarës dhe të kinse çmisticimit të miteve nacionale, në hapësirën shqiptare janë shfaqur tendenca çintegruese dhe janë ringjallur paragjykimet krahnoriste, të cilat kombin shqiptar e trajtojnë më shumë si ansambël fisesh sesa si komb modern me vetëdije historike për të kaluarën e vet dhe me vizion të qartë për të ardhmen. Vlerat identitare të kombit, ato që quhen shtylla të tij: gjuha, tradita, kultura, heronjtë kombëtarë etj. kanë marrë dhe vazhdojnë të marrin goditje nga më të shëmtuarat nga të ashtuquajturit "rimohues" (term i Kadaresë), që, në të vërtetë, s'janë tjetër pos mercenarë intelektualë të të gjitha ngjyrave. Letërsia shqipe sot krijohet jashtë qaqeve të një metode të vetme krijuese, çfarë ishte realizmi socialist në të kaluarën, në Shqipëri, por edhe një lloj estetizmi shterp në Kosovë. Shkrimtari shqiptar sot, ndryshe nga ç'ndodhte më parë, sidomos në Tiranë, është i lirë ta zgjedhë temën, stilin dhe metodën e vet krijuese. Rënia e censurës dhe e diktatit i hoqi kufizimet në këtë plan. Por censura e dikurshme, e cila në Shqipëri kishte karakter kryesisht ideologjik, kurse në Kosovë karakter kryesisht kombëtar, është zëvendësuar tani, në erën e pluralizmit dhe të mendësisë konsumuese, nga shpërfillja e lexuesve dhe e shoqërisë ndaj librit, që, sipas Josif Brodskit, është më e keqe se censura dhe mund të quhet krim. Djegien e librave në sistemet totalitare, Brodski e quan krim. Por ka një krim edhe më të rëndë - thotë ky poet, laureat i Çmimit Nobel në vitin 1987 - përbuzja e librave, mosleximi i tyre - shton ai, për të përfunduar se kur këtë krim e kryen individit e paguan me jetën e vet, por nëse këtë krim e kryen kombi - ai e paguan me historinë e vet. (2011)



Rreth filmit artistik *DELEGACIONI*

NJË PLUMB FATAL

Nxjerrja me të shpejtë nga burgu i një disidenti për shkak të ardhjes së një delegacioni evropian, në përbërje të të cilit është edhe një shok kursi i të burgosurit tonë, përbën pa dyshim një gjetje të rrallë e të veçantë të skenaristit Artan Minarolli

Dashnor KOKONOZI

Nuk e di për çfarë arsyes nuk më qe bërë mbarë të shoh filmin artistik shqiptar "Delegacioni" (Le dernier prisonnier, sipas versionit frëng). Por, nëse e vura menjëherë në krye të përparësive të mia, kjo ndodhi fill pas pasish dokumentarin "Fluturat" të regjisorit Bujar Alimani, që është edhe regjisorit i filmit të mësipërm. Ende nuk kisha parë të dilte nga duart e një krijuesi shqiptar një dokumentar me një estetikë dhe gjuhë filmike aq shprehëse, sa pa asnjë ndërhyrje tjetër veç dëshmive të protagonistëve të tij dhe të një montazhi të studiuar në mënyrë milimetrike, të arrinte të shprehte vuajtjet e dhimbjen e atyre grave dhe vajzave të familjeve të njohura shqiptare në kampet e internimit të regjimit komunist. Edhe pse shumë prej tyre kishin lindur e ishin rritur në internim, me shumë dinjitet shmangnin ato çdo lloj opiniononi ndaj torturuesve të tyre, duke lënë të nënkuptohet gjithçka. Dokumentari më ngjalli po aq emocione sa edhe "Shoah", dokumentari

monumental i C. Lanzman-it, për kampet e shfarosjes. Madje, edhe gjuhën filmike të dokumentarit të Alimani e shoh në të njëjtën linjë estetike sikundër ajo e Lanzman-it. Që në sekuencat e para filmike të filmit "Delegacioni" ndjeva sigurinë se me subjektin dhe atmosferën që krijonte, filmi ishte një thyerje e vërtetë me gjithë çfarë kisha parë deri atëherë. Veçanërisht këmbëngul te gjuha filmike e Alimani. Rrjedhshmëria e skenave dhe atmosfera të lë përshtypjen se je ulur diku dhe sheh jetën që rrjedh para teje... Profesionalizëm i nivelit të lartë. Nxjerrja me të shpejtë nga burgu i një disidenti për shkak të ardhjes së një delegacioni evropian, në përbërje të të cilit është edhe një shok kursi i të burgosurit tonë, përbën pa dyshim një gjetje të rrallë e të veçantë e skenaristit Artan Minarolli. Tek e shihja, kisha përshtypjen se ndodheshja përpara një filmi me të ardhme të jashtëzakonshme në sallat botërore. V. Zhysti, Sh. Xhepa dhe Xh. Ferri janë në lartësinë e talentit të tyre, veçanërisht i pari se të tjerët

kanë ca prirjen të luajnë "të keqin". E megjithatë, me sa di, edhe pse filmi është vlerësuar shumë nga specialistët, nuk ndodhi ajo që pritej. IMDb për të ka një vlerësim 6.6/10, që nuk është i keq, përkundrazi, por duke lexuar edhe shënimet pozitive të shikuesve francezë që janë mjaft dashamirës ndaj tij, nuk e kuptova menjëherë përse ky film nuk u ngjit më lart në klasifikim. Përpiqem të kuptoj këtë enigmë dhe i kthehem sekuencave të tij të veçanta. Çfarë i mungon një filmi të tillë, që në dukje të lë përshtypjen se ka gjithçka që duhet? Përshtypja që krijova, dhe këtë do ta them ashtu siç e mendoj, është se ky film përfundon aty ku në një farë mënyrë duket se me të vërtetë fillon. Plumbi i revolverit të Asllanit (Xh. Ferri) është fatal jo vetëm për Leon (V. Zhusti), por edhe për vetë filmin. Qe një vrasje krejtësisht e panevojshme! Brutaliteti i regjimit po shfaqej ngadalë, por vetëm në anën e tij të jashtëme. Bisedat e shkurtra e të prera gjatë rrugës, qenë si një bisturi që po hapnin plagët e infektuara. Dhe papritur vjen një plumb dhe gjithçka

ndalon aty sa kohë që ishin të gjitha mundësitë që autopsia e sapo filluar të shkonte shumë më thellë në një linjë sa brutale aq edhe parodike. Se kemi rastin e jashtëzakonshëm që regjimi i Tiranës po kërkonte të bënte "figurë të mirë" dhe sa më shumë përpiquej aq më qesharak bëhej. As që guxoj të mendoj se çfarë mrekullie do të ishte skena e takimit të Leos që vinte nga qelia me shokun e tij të dikurshëm të universitetit (Richard Sammel), të cilin Evropa e kishte dërguar të inkurajonte reformat. Dhe kjo në prani të ofiqarëve të regjimit të "mallëngjyer" për të drejtat e njeriut! Pa folur për qindra detaje të mundshme hipokrizie dhe grimi të trashë me të cilin regjimi po përpiquej të paraqitej para delegacioneve evropian, duke mbajtur pas duar e përgjakura. Por kjo nuk shkon në fund. Siç thamë, vjen një plumb i çuditshëm dhe i pamotivuar dhe ajo fillesë e mrekullueshme, ndërpritet aty. Gjithsesi, mendimi im.



Tregim

NEPSQARËT

Puntorie ZIBA

Nuk do të doja që kjo ditë të zbardhte kurrë. Sot, nëse dikush më pyet se në cilën ditë të javës kam lind, nuk do të jem në gjendje t'ia tregoj as vitin. Radha e burrave që do të mbush oborrin e vogël do të nis prej te pragu, deri te druri i fikut afër avllisë së ulët të ndërtuar me tulla të kuqe. Burrat dhe disa gra vijnë me qëllim kaotik. Të gjithë kanë oreks të pashmangshëm. Duan ta gllabërojnë shtëpizën time. Këtë shtëpizë e shohin si tempull, bile disa prej tyre edhe e mitizojnë. Ca re të zeza që më rrinë mbi kokë, paralajmërojnë shi. Ndihem e molisur. Edhe zëri i zogjve nuk e ngushëllon shpirtin tim. Gjysmë motra doli nga dera e përgjumur dhe e pakrehur. Dukej e zbehtë dhe pa pikë dëshirë për të dalë nga ëndrra që mbase e kishte shikuar mbrëmë. Dukej e rënë brenda në ekstazë. Gjendja e saj shpirtërore dhe fizike ishte mjaft delikate. Rrinte pupas e mbledhur sa një grusht. Shihet qartazi se nuk i interesonte ajo që do të ndodhte sot në oborrin tonë. Nga lëvizjet që i bënte me figurën e saj, dukej se merrej me dukurinë e halucinationeve. Sot më duhej gjysmë motra me mend në krye, luftarake për atë që na përket. Dita ime më e trishtuar se kurrë, më gjet krahë-këputur. I shihja të gjithë me radhë dhe sytë për të shtatën herë më ngecën te trangu me degë të shpeshta matanë gardhit. Kujtoja se pas atij trangu vazhdon ritualin e përditshëm Arturi. Dëshiroja të vinte sa më shpejt, meqë nuk duroja pa i thënë se një copë shtëpizë e nxorët në ankand në mënyrën më të turpshme. Këtë punë të ligë mund ta ndërmarin një grup burrash të çoroditur, të pacipë... Është e shëmtuar puna kur gjithçka bëhet kundër vullnetit dhe interesit të sovranit. Arturi i veshur me pelush, erdhi i fundit. Dukej serioz dhe arrogant. I shihte të pranishmit dhe ngrinte vetullën e djathtë lart. Pas Arturit hyri një grua me veshje ekstravagante që dukej si

magjistare. Ajo kishte veshur një fustan të mëndafshhtë, si fustan ballosh vjenzë me dekolte të hapur. Cicat e saj të mbushura me silikon sa nuk plasnin nga fustani i ngushtë. Pjesëmarrësit në ankand ishin radhitur sikur të gjendeshin në arenë amfiteatri. Ata më të guximshmit qëndronin në rëndin e parë, kurse të frikësuarit nga shumica e parave, rrinin mbrapa. Pas avllisë së ndërtuar me stil, ishin varur me duar një numër i madh fëmijësh adoleshentë. Shumica ishin kurioz ta shihnin atë që do të ndodhte në oborr. -Kjo shtëpi është mishërim i tipareve më të larta, i vlerave më të mira, është frymëzim dhe pikësnyim.- thatregtari. -Është ëndrra ime.- foli polici dhe preku armën me dorën e djathtë. - Shtëpi e shenjtëruar nga perëndia. Qoftë risku im!- tha gazetari i njohur. -Bravo! - brohoritën disa nga të pranishmit. Për një çast filloi të bjerë shi rrebes. Fëmijët të bërë qull, hoqën duart nga tullat e avllisë dhe ia mbathën nëpër shtëpi. Vetëm pjesëmarrësit në ankand rrinin si dordolecë të lagur. Ata nuk lëvizën nga vendi. -Mund ta vazhdojmë ndonjë ditë tjetër këtë muhabet.- ju thashë unë. -Jo, u përgjigjen njëzëri të gjithë. Zëri i Arturit u dallua nga timbri i tij i veçantë. E pashë se të gjithë kishin një mendje. Nuk e kisha të qartë përse nguteshin kaq shumë. Te pragu i derës, me letër të bardhë në dorë doli një djalosh i zeshkët që i kishte kaluar të tridhjetat. Sikurse dukej puna, kishin bërë edhe skenar me pyetjet e nevojshme për të shitur shtëpizën në ankand. Djaloshi filloi fjalimin e tij me një përsëritje duke e rregulluar me duar jakën e xhakës së bërë qull nga shiu: Blerja e kësaj shtëpize është investimi më i madh që mund ta bëni ju, prandaj duhet të informoheni mirë, dhe duhet të jeni vigjilent për këtë që e bleni. Në fillim ju kisha lutur të mos keni emocion. Pronare e shtëpisë është Meri Pocesta dhe gjysmë motra e saj. Kësaj shtëpie i bie dielli njëzet e katër orë,

dimër, verë. Në fillim dot'ujap informacione rreth riparimeve. Në këtë shtëpi nuk guxon të ngulni asnjë gozhdë të vetme, meqë është e mbrojtur me ligj. Ai që e blen dhe merret me riparime, dënohet me burg. Shtëpia ka mure të trasha, themele të forta edhe pse është ndërtuar në vitin 1882. Shtëpizën nuk e shembi as tërmeti i vitit 1963, kur tërmeti e shkatërroi qytetin. Ai nga larg dukej si i bombarduar nga ndonjë bombë atomike. Zhurmë rreth kësaj shtëpie nuk ka. Fqinji i vetëm është Artur Tosku, i cili ndodhet këtu në mesin tonë, meqë është i interesuar ta blejë. Të gjithë të pranishmit kthyen kokën dhe e shikuan Arturin me kërshtëri. Ata nuk bezdiseshin nga pikat e shiut që ju hynin në sy, në hundë e në gojë. Mendjen e kishin te shtëpia që damarët i lidheshin me Kallanë. Unë dhe gjysmë motra rrinim nën një ombrellë të zezë prej burrash të cilën e mbante në bodrum babai. Djaloshi i zeshkët i luti të gjithë të heshtnin dhe pabërëzët' i përcjellin shifrat, pastaj i luti të pranishmit ta ngrënë dorën po qe se duan të fillojnë të parët. -Jap një gjysmë milioni, euro.- u dëgjua zëri i Arturit pa iu dridhur qepiku. Në oborr u dëgjua zëra kakofonik. Unë fillova të dridhem nga frika e shumë marramendëse për një shtëpizë njëkatëshe që nuk kishte më shumë se njëqind metro katrorë. -Jap një milion euro!- u dëgjua zëri i gruas me gjoks të madh prej silikonit. -Jap dy milion!- tha Arturi pas një pauze që nuk zgjati shumë. -Dy milion the?- iu drejtua Arturit, gruaja me gjoksin e madh. -Dy milion dhe nuk e luan topi. -Ke para të vjedhura.- thanë disa. -Shet drogë.- tha gruaja ekstravagante. -Je i korruptuar.- folën njëzëri të gjithë. -Nuk jepen aq shumë para për një shtëpizë përdhese me një çati të brishtë që mund të rrëzohet nga një furtunë me shi të rrëmbyer.- u dëgjua zëri i ngjirur i djaloshit të zeshkët. Arturi futi dorën në brez, nxori armën dhe shtiu shtatë herë dre-

jt qiellit. Cicërima e zogjve të trembur m'i mbushi sytë me lot. Ata ikin duke përplasur flatrat. Fqinji im, ju tha të pranishmëve të mos e nënvlerësonin tempullin, vendin për të cilin ka nderim të thellë. Edhe polici nxori revolen nga brezi dhe e luti Arturin ta fus armën brenda. Ata u panë sy në sy, si dy egërsira që luftojnë përnjëcopëgjahdhëfuten armë nënë brez. Shiu vazhdoi të bjerë më i rrëmbyer. Para syve të blerësve u zbeh gjithçka. Të gjithë i lëviznin gishtërinjtë sikur donin t'i hanë thonjtë nga inati, meqë dëshirat e tyre po të mbeteshin vetëm iluzione. Pamja e fytyrave të tyre dukej sterrë nga mërzia. Edhe gazetarit që i kishin dalë fjalët se të mbulon me para, iu mjegulluan sytë. Nepsi i tyre mori fund sapo dëgjuan dymilionshin që e përmendi i fundit, Arturi. Ankandi nuk zgjati shumë. Arturi ua mbylli gojën të gjithëve. Unë dhe gjysmë motra rrinim si pula të lagura. Së pari, nuk e kuptoj Arturin se çka i duhej kjo shtëpizë e ndërtuar para një shekulli. Në atë çast ktheva kokën, pashë frëngjinë nga e cila përcillja rutinën e tij dhe m'u drodh trupi sikur nuk do ta shihja më kurrë. M'u duk se shtëpia luhatej dhe mezi qëndronte në këmbë. Arturi rrinte me kokën e zgjatur lart dhe me një sedër prej një burri vetjak. E di se ai dëshiron të sundon moralisht. Gjatë gjithë jetës, prej kohës kur babai im iku dhe më la vetëm në këtë shtëpi, e dija se çka është sedra e burrit. Babai herë e adhuronte e herë nuk e shihte me sy këtë shtëpizë, meqë mërztetej me nënën kur ziheshin. Ajo shpesh i thoshte kollovar. Ky ambient ia gërryente zorrët dhe ia bënte trupin me mornica. Por sapo qetësoheshin, përqafoheshin dhe ndiheshin të lumtur për këtë trashëgimi të veçantë. Unë, kurrë nuk mund t'i shoh burrat ndryshe përveç si sundues, si uzurpues, si gllabërues, si sedër sëmurë, si të korruptuar... Disa prej tyre jetojnë për të sunduar gruan, lagjen,



Poezi: Nuri Plaku

DIELLI I LYPSARËVE

Sot, dielli në qytetin tim
Lindi nga një kosh plehrash
Dhe ndriçoi fytyrën e djaloshit lypsar,
Që vraponte nëpër ag
Me një trastë hekurishtesh mbi shpinë
Dhe një grepç teli në dorë
Për të puruar dallgët e ditës,
Që i ngulnin dhëmbët e urisë mbi trup.

Pas tij dielli ndriti fytyrën e një plaku të verbër,
Mbledhur galiç pas hirit të vatrës.
Ndriti dhe fytyrën e një plake të gërmuqur
Dhe fytyrën e një nuseje të dobësuar,
Që ushqente foshnjën, mbështetur pas muri.

Sot, dielli lindi nga një kosh plehrash
Dhe ishte thjesht
Një bukë gruri.

KËMBANAT

Mbrëmë, tek porta e qytetit
Hingëlliti një kalë i vdekur
Me zë të kobshëm.

Askush nuk e mori vesh nga erdhi
Por thonë se është shenjë e mirë origjine.
Kur hingëllinin kuajt dikur, njerëzit vishnin këpucët e udhëve
Por tashmë udhët e kuajve janë bërë litar pluhuri
E i mbajnë ngjacuar
Në livadhin e përrallave.

Në mëngjes, kali u bë kambanë kishe
Dhe ra fortë, e fortë
Si për ditë pashke.

Njerëzit mbanin këmbët e bënin kryq
Ka kohë që në qytet
Nuk janë dëgjuar kaq shumë kambanat.

Më parë, kur qyteti ishte i vogël
Ato binin për çdo vdekje njeriu,

Ndërsa tashmë
Nuk i ndjekin dot njerëzit që ikin.

Dhe vjen ti përcjellë
Një kalë i vdekur...

QIRIRI PREJ UJI

Ky lum është një qiri prej uji
Që pret të digjet në altarin e qytetit.
Por askush nuk guxon
Të shkrepni një xixë zjarri.

Ah! U mundova njëherë ta ndizja
Me xixën e një vetëtime
Po Zoti tështiti atë çast
Dhe xixa u shua në dorën time.

Lumi mblodhi 1000 shira
E vërshoi brenda meje me tërbim.

Tashmë
Edhe unë jam një lum
Që pres të digjem
Në altarin e qytetit tim.

PËLLUMBAT E TREMBUR

Mbi sheshin "Nënë Tereza" të qytetit tim
Fluturojnë pëllumba të trembur.
Kalimtarët i ndjellin me ushqime
Por ata çukisin në ajër
Mbi frikën e tyre.

Vetëm hijet përpëliten të qeta mbi shesh
Hijet dhe ca pendë të përgjakura
Si trofe e egër e fitores.

Pëllumbat e trembur në sheshin "Nënë Tereza,"
Ende nuk e njohin,
Paqen e shenjtores!

MALLKIMI I QYTETIT

Tri herë më mallkove o qytet
Pa më parë në sy
Dhe mua mu duken
Si tri këngët e një gjeli në mesnatë.

Kurrë se besova mallkimin tënd prej ati
Dhe ndeza tri qirinj në altarin e kishës
Të përcillja te Zoti
Tri lutje për ty.

Tri lutje o qytet
Për tu parë
Sy më sy.

E ti prapë nuk munde...

Në dritën e qiririt të tretë
Mu shfaq emblema jote
Në dhëmbët e një Jude.

ZAMBAKËT ÇELIN ME NGJYRA TË VJEDHUR

Në qytetin tim
Zambakët çelin me ngjyra të vjedhura.

Kur veson nata
Zambakët vjellin mëkatin e ditës
Dhe të nesërmen bëhen ndryshe.

Të jesh ndryshe në këtë qytet, do të thotë të jesh i zi
Kur e zeza digjet bëhesh sërish ndryshe
Atëherë je i bardhë...

I zi, i bardhë,
I bardhë, i zi
Kudo kutërbonjnë ngjyra të djegura...

Në qytetin tim
Zambakët çelin
Me ngjyra të vjedhura.

DITAR ME VIZATIM

Ajo vizatoi një dritare me kanata të mbyllura
Dhe një fije bari,
Që fëshfërinte mbi xham.

Natën
U zgjat tinëzisht një dorë misterioze
Dhe vrau fijen e brishtë.

Vajza qau dhe vizatoi përsëri dritaren me kanata të mbyllura
Dhe një fije bari të vdekur.

Herën tjetër vizatoi dritaren me kanata të mbyllura
Dhe një flutur të qeshur mbi parvaz.

Natën
U shfaq dora misterioze
Dhe fluturua u gdhë e vrrarë.

Vajza qau dhe e vizatoi sërish dritaren me kanata të mbyllura
Me një flutur të vdekur pranë.

Pastaj vizatoi një tjetër dritare me kanata të mbyllura
Dhe një zog me pupla cicërimë.

Atë natë
Edhe zogu heshti i vrrarë.

Vajza qau dhe vizatoi një tjetër dritare me kanata të mbyllura
Dhe një zog të vdekur.

Pastaj i mblodhi të gjitha vizatimet
Dhe ju vuri përsipër
Një titull intim.

I dashur
Qyteti im!

Poemë

AVERNO

Louise GLÜCK

I
Njeriu vdes kur shpirti i tij vdes.
Përndryshe, jeton.
Mund të mos bësh asgjë të do-
bishme,
por vazhdon përpara-
tjetër zgjedhje s'ke.

Kur ua them këtë fëmijëve të mi
ata më shpërfillin.
Të moshuarit, mendojnë ata -
këtë bëjnë gjithmonë:
flasim për gjëra që askush s'i sheh
për të mbuluar të gjitha qelizat e
trurit që po humbin.
Ata i shkelin syrin njëri-tjetrit
tek dëgjojnë një plak duke folur
për shpirtin
kur ai nuk mund të kujtojë as
fjalën karrige.

Është e tmerrshme vetmia.
S'e kam fjalën për të jetuarit
vetëm,
por të jesh aq vetëm sa të mos
kesh asnjë
që të të dëgjojë.

Më kujtohet fjala 'karrige'.
Thjesht nuk kam interes ta kujtoj.

Zgjohem duke menduar:
duhet të përgatitesh,
së shpejti shpirti do të dorëzohet -
të gjitha karriget e botës nuk do
të ndihmojnë.

Unë e di se ç'thonë ata kur jam
jashtë dhomës.
Mos duhet të bëj ndonjë vizitë? A
duhet të marr ndonjë mjekim për
depressionin?

Unë mund t'i dëgjoj pëshpërimat
e tyre duke planifikuar se si t'i
ndajnë shpenzimet.

Dhe dua veç të bërtas:
Të gjithë jetoni në ëndërr.

Ajo është keq, mendojnë ata, tek
më shohin të rrëzohem e copëtua-
ar.
Edhe më keq prej kumteve që
marrin këto ditë.
Sikur të kisha të drejtë ta dija
këtë kumt të ri!

Epo, veç ata e gëzojnë këtë të dre-
jtë.

Ata po jetojnë në një ëndërr dhe
unë jam duke u përgatitur
për të qenët e padukshme. Dua të
ulërij
mjegulla është pastruar -
Është si një jetë e re:
veçse s'kam interes për ç'më pret;
përfundimi dihet.

Pa mendoje njëherë: gjashtëdh-
jetë vjet ulur në karrige. Dhe tani
shpirti i të vdekshmit
kërkon kaq hapur, kaq pa frikë -
të ngrejë siparin.
Për të parë se kujt do duhet t'i
lërë lamtumirën.

II
Unë nuk u ktheva për një kohë të
gjatë.

Kur fushën e pashë sërish, ishte
fundvjeshte.

Këtu, vjeshta përfundon thajse
para se të fillojë -
të moshuarit nuk vishen me
vjeshtë.

Fusha ishte e mbuluar me dëborë
të papërlyer.
Nuk kishte asnjë shenjë të asaj që
kish ndodhur.
Nuk mund të di as nëse fermeri
e kishte rimbellë apo jo.
Ndoshta ai hoqi dorë dhe u lar-
gua.

Policia nuk e gjeti vajzën.
Më pas, thanë se ajo u zhvendos
në tjetër vend,
një vend pa fusha.
Katastrofa si kjo
nuk lënë gjurmë në tokë.
Dhe njerëzve u pëlqen kjo -
mendojnë se u jep
një rifillim jetësor.

Qëndrova gjatë, fiksuar në boshë-
si
As e vura re sa errësirë ishte, sa
ftohtë.

Një kohë e gjatë - nuk e di se sa.
Kur toka vendos të mos ketë më
kujtesë koha duket thajse e pak-
uptimtë.

Por jo për fëmijët e mi. Ata më
janë vënë pas
për të bërë testamentin; të
shqetësuar se qeveria
do të marrë gjithçka.

Sikur të vinin me mua ndonjëherë
të shihnin fushën nën petkun e
dëborës.
Gjithçka është shkruar atje.

Asgjë: Unë s'kam asgjë për t'u
dhënë.

Kjo pikësëpari.
Së dyti: Nuk dua të digjem.

III
Nga njëra anë, shpirti endet.
Nga ana tjetër, humanët jetojnë
mes frikës.
Midis dy brigjeve, hon i zhdukjes.

Disa vajza më pyetën
në do ishin të sigurta pranë
Avernos-
kanë ftohtë, duan të shkojnë për
pak kohë drejt Jugut.
Njëra thotë, si me shaka, por jo
shumë larg në Jug.-

U them, "aq i sigurt sa çdo vend
tjetër"
dhe kjo i bën të lumtura.
Por asgjë nuk është e sigurt.

Merre një tren, zhduku!
Shkruaje emrin në një dritare,
dhe avullo!

Vende të tilla ka kudo,
vende ku shkon vajzë,
nga ku nuk ka kthim pas.

Ashtu si fusha, ajo që digjet.
Pas kësaj, vajza zhduket.
Sikur të mos kish ekzistuar kurrë,

e ne s'kemi prova për asgjë.

E tëra që dimë është:
fusha digjet.
Dhe ne e kemi parë tek digjet.

Kështu që duhet ta besojmë va-
jzën, në atë që bëri. Përndryshe
janë veç forca që s'i kuptojmë,
forca që s'ndodhë botën.

Të lumtura vajzat, mendojnë për
pushimet.
"Mos e merrni trenin" -u them.
Ato shkruajnë emrat në xhamat e
avullit të udhëtimit.

Sa do doja t'u thoja, "ju jeni vajza
të mbara,që përpiqeni të lini em-
rat tuaj pas".

IV
Tërë ditën e kaluam duke lun-
duar në arkipelag,nëpër ishujt
e vegjël pjesë të gadishullit,deri-
sa u shkëputën në fragmentet që
shihni duke pluskuar në ujërat e
detit verior.

Ata më dukeshin të sigurt,
sepse askush nuk mund të jetojë
atje.

Më vonë u ulëm në kuzhinë
duke parë muzgun dhe pastaj
borën që binte.

Ne heshtim, të hipnotizuar nga
rënia e dëborës si të ishte një lloj
turbullimi më parë i fshehur që
po kthellohej,diçka nga brendë-
sia e natës u bë më e qartë tani -

Në heshtjen tonë, ne bënim
ato pyetje që miqtë e besuar
njëri-tjetrit i drejtojnë, pas një
tronditjeje të madhe, secili duke
shpresuar se tjetri di më shumë
dhe kur s'ndodh kështu, shpresoj-
jnë se përshtypjet e shkëmbyera
do t'i barazvlejnë intuitës.

Çfarë përfiton nëse e sforcon
veten të ndërgjegjësohet se duhet
të vdesë?
A është e mundur të humbasësh
vërtet dikë?

Pra, pyetje të tilla.

Bora ishte e rëndë. Nata e zezë
shndërrohej në një ajër të bardhë
mbyttës.

Po diç na mbeti pa na u zbuluar:
Ishte kuptimi i gjithë kësaj.

V.
Pas të parit dimër, fusha nisi të
gjallohej sërish.
Por ndryshe, nuk kishte më braz-
da të rregullta.
Era e rrurit ndihej ende, një lloj
aromë e rastësishme
e përzier me barëra të këqija, të
cilat njerëzit ende s'dinë përse t'i
përdorin.

E çuditshme- askush nuk e dinte
ku kishte shkuar fermeri.
Disa njerëz mendonin se kish
vdekur.
Dikush tha që ai kishte një vajzë

në Zelandën e Re,
që shkoi atje për të rritur
nipërit e mbesat në vend të gru-
rit.

Natyra, ndryshe nga ne, e zbulon
vetveten,
nuk ka një depo të kujtesës.
Fusha nuk frikësohet nga për-
bashkimi,
nga vajzat e reja. Edhe brazdat
nuk kanë kujtesë. Toka vritet, dig-
jet, dhe një vit më vonë gjelbëro-
het sërish sikur asgjë e pazakontë
të mos kish ndodhur.

Fermeri sheh nga dritarja.
Ndoshta në Zelandën e Re, a diku
tjetër.
Dhe mendon:"jeta ime ka mbaru-
ar".
Gjithë jeta e tij ishte ajo fushë
ai nuk beson më në bërjen e
ndonjë gjëje
përtej asaj cope tokë. Toka, men-
don ai,
më mposhti.

E kujton ditën kur fusha u dogj,
Jo, rastësisht!- mendon.
Diçka thellë brenda vetes i thotë:
Mund të jetoj me këtë,
ose mund të përballem pak më
vonë.

Më i tmerrshmi çast- ardhja e
pranverës
pasi puna e një jete u bë shkumb
kur e kuptoi se toka
nuk dinte të ndiente keqardhje,
kjo do kish ndryshuar gjithçka.

Ajo vazhdoi të jetojë pa të.

(Nga vëllimi poetik "Averno", 2006)

Përktheu nga origjinali: MARSELA
NENI

*Averno/us/-i është emri i lashtë
i kraterit të një vullkani pranë Ko-
mos (Itali) ku gjendet dhe një liqen
i vogël. Në shoqërinë e lashtë ro-
make besohej se Avernus ishte portë
hyrëse për në përtejbotë (bota e
nëndheut-Hadi) dhe është portret-
izuar si e tillë në veprën "Eneida" të
Virgjilit.

Nga vëllimi poetik "Averno", 2006

Louise Glück është një poete dhe es-
eiste amerikane e lindur në vitin 1943
në Nju Jork. Fituese e çmimit Pulitzer
me përmbledhjen poetike "Irisi i egër"
(The Wild Iris, 1993), si dhe fituese e një
sërë çmimesh kombëtare e ndërkom-
bëtare,ajouvlësuameÇmiminNobel
për Letërsinë në vitin 2020 me motiva-
cionin "për zërin e saj të pagabueshëm
poetik që me bukuri të ashpër e bën
ekzistencën individuale universale".
ekzistencën individuale universale".
Poezia e Glück që në fillimet e saj ka
ndjekur një kurs individual të dal-
lueshëm nga poezia e shumë bash-
këkohësve të saj. Ajo i bindi kritikët
për stilin e kontrolluar dhe elegant
me të cilin krijon sekuenca të gja-
ta narrative me elemente autobi-
ografike që të kujton poezinë e R.
Lowell, S. Plath dhe A. Sexton, si
dhe për nga qartësia, ashpërsia
dhe dëshira për të qenë një poezi

universale ofron ngjashmëri me poezinë e Emily Dickinson. Poezia e saj është cilësuar si një "poezi e mendjes së hapur, që i reziston me ngulm mendësisë së mbyllur, që nuk heq dorë nga intensiteti lirik, por pa u përpjekur për një pajtim të lirikës

dhe filozofisë në dëm dhe zvogëlim të të dyjave". Glück ka arritur një lloj bashkimi ku të dy disiplinat mbeten të fuqishme. Poezia e saj nuk është aq shumë një meditim për botën, por një angazhim pasionant i vetvetes me ekzistencën e vet.

Poezia "Averno" është poezia përmbyllëse e vëllimit poetik me të njëjtin titull, ku poetja ka shfrytëzuar mitin antik grek të Persefonës (e cila braktis të ëmën për të shkuar pas një dashurie të errët), për të trajtuar tema si vetmia, melankolia, dashu-

ria, jeta dhe vdekja. I gjithë vëllimi poetik i cili përshkohet nga një tension që lind prej frikës nga vdekja dhe përballja me faktin e të qenët i vdekshëm, në thelb është një proces çlirimi nga kjo frikë dhe një celebrim i jetës.



Shënimi i një redaktori

POLIKRIZA

"Vullkani ndoshta nuk është më vetëm simboli i dhunës sociale apo luftarake, por metafora e një bombe të vërtetë ekologjike me sahat që do të vijë" (Charif Majdalani, "Vallëzimi në këmbët e një vullkani")

Një fotografi e kryeredaktorit Daniel Simon për më shumë se një dekadë e gjysmë, që 'World Literature Today' ka marrë pulsën, si të thuash, të përgjigjeve të shkrimtarëve ndaj krizës klimatike planetare. Në numrat specialë të viteve 2008, 2011, 2014 dhe 2019, poetët, eseistët dhe romancierët, në dialog me shkencëtarët, kanë parë, me një përzierje mosbesimi dhe alarmi, teksa bota duket se del jashtë kontrollit rreth tyre. Shikimi, por edhe dokumentimi i fatkeqësisë dhe përfytyrimi i të ardhmes së zymtë dhe utopike. Në sondazhin e fundit të 'World Literature Today' për klimën ndërkombëtare të ndezur, "Shkrimi i polikrizës", ne kryesojmë me një ese nga Richard Heinberg nga Instituti Post Carbon. "Ka shumë kërcënime të reja dhe serioze po shfaqen dhe kaq shpejt," - shkruan Heinberg, "sa që një fjalë ka ardhur në qarkullim për të përshkruar këtë konvergjençë të paprecedentë të rrezikut - **polikrizë**". Dhe aksionet e polikrizës - atë që Heinberg e quan "shkalla e pasojave" - janë bërë gjithnjë e më të pakundërshtueshme. Megjithatë,

Heinberg shpjegon qartë se "makinat e gjenerimit të rrezikut/krizës" e kapitalizmit me lëndë djegëse fosile, nuk mund të hiqet thjesht nga priza. Në fund të fundit, përfundon ai, ne jemi "bërë armiku ynë më i keq" dhe "mund të mos ketë asnjë rrugë përpara që nuk kërkon një sakrificë të konsiderueshme të pasurisë, dominimit ose rehatisë. Mbijetesa kolektive do të kërkojë të lëmë mënjane mendjemadhësinë tonë dhe të pajtohemi me kufijtë mjedisorë dhe socialë." Heinberg sheh një fije shprese në faktin se njerëzit janë "primatë të zgjuar, gjuhësorë, ultrasocialë, që bëjnë vegla". Shkrimtarët, si primatë par excellence të krijimit të mjeteve gjuhësore, kanë mbajtur prej kohësh një pasqyrë të botës natyrore. Poetët, në veçanti, bazohen në lidhjen aborigjene midis vetvetes dhe ndjenjës së lidhjes së shenjtë me tokën në një mënyrë parësore. Poetja kanadeze filipinase Rina Garcia Chua, duke shkruar pas zjarreve dhe kupolës së nxehtësisë që shkatërruan Paqësorin Veriperëndimor në 2022-2023, ofron një poezi të mbushur me ankesa - pikëllim që qëndron në fund

të mushkërive të folësit, ngjyron muzgun "spektral portokalli", gëlltitet në ëndrrat e saj, që "rrëshqet dhe përpëlitet" ndaj gjithçkaje që prek. "Unë thith një frymë," shkruan ajo, "për t'i rezistuar rrëzimit të një gjoksi. / Pak ajër për të vrapuar; disa buzë për të kënduar." Në "Gjiri i kuajve të vdekur", poeti venezuelas, Santiago Acosta, katologon mbetjet e kulturës sonë të hedhura në hapësirën kufitare të një ishulli në majë të një landfilli (vend-groposje) të vjetër që del në gjirin e Xhamajkës të Bruklinit. Tre poezi të shkrimtarëve argjentinas Guarani, të përkthyer nga Whitney DeVos dhe Valeria Meiller, gjithashtu zënë vend në ekotone të brishta; në "Arkaike" të Ana Gayoso, "forca e shpirtit digjet" në një peizazh nga kthesat Edenike dhe të shkatërruar. Dhe në trillimet spekulative të shkrimtarës ganeze, Cheryl S. Ntomy dhe shkrimtarës afrikano-jugore, Vuyokazi Ngemntu, rrëfyeset përkatëse femra manifestojnë beteja për sovranitet politik dhe trupor nëpërmjet alegorive mjedisore, njëra utopike, tjetra distopike. Kur ekipi redaktues i WLT filloi së

pari të diskutonte idenë e kësaj çështjeje, ne parashikuam një fokus në Jugun Global, pasi ai rajon mban peshën kryesore të disa prej efekteve më të këqija të katastrofës klimatike. Megjithatë, sido që të jetë përcaktuar Jug Global, gjeografia dhe ekonomia e polikrizës nuk njohin kufij. Në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, Deklarata e përbashkët për klimën, natyrën dhe njerëzit - në një nga dhjetë premtimet në marrëveshjen përfundimtare të 15 dhjetorit 2023, theksohet se "adresimi i ndryshimeve klimatike, humbjes së biodiversitetit dhe tokës degradimi së bashku", duhet të bëhet në "mënyrë koherente, sinergjike dhe holistike, në përputhje me shkencën më të mirë në dispozicion". Përballë provave dërmuese shkencore për shkallën planetare të krizës, sinergjitë e kulturës dhe shkencës, mund të ofrojnë mundësi për mirëkuptim, angazhim emocional dhe ndoshta një vizion që premtion diçka tjetër përveç dëshpërimit të pandërprerë. (Worldliteraturetoday.org) **Solli në shqip: Fitim Nuhiu**

Profile: Nizar Teufik Kabbani

POETI QË SHKROI HISTORINË E GRAVE

Kabbani, është poeti që tundi botën dhe pushtoi zemrat e njerëzve në gjysmën e dytë të shekullit të XX



Artan ALMETA

Historia e letërsisë botërore ka njohur në çdo periudhë të saj njerëz të mëdhenj, shkrimtarë, artistë, poetë dhe gjeni. Njerëz që shkruajnë ka shumë, ama poetë ka pak. Poetë ka shumë, ama gjenitë poetikë janë të rrallë, më të rrallë se diamantet në shkretëtirë. Një prej gjenive që dëshmoi bota ishte edhe poeti Arab i shekullit të XX, Nizar Kabbani. Kabbani, është poeti që tundi botën dhe pushtoi zemrat e njerëzve në gjysmën e dytë të shekullit të XX. U lind më 23 mars të vitit 1923 në Damask (Siri) në një prej familjeve më të vjetra damaskiane, siç ishte familja Kabbani. Ai ishte poeti i cili diti të ndërthurë aq bukur thjeshtësinë, nacionalizmin, romancën dhe elegancën e vargut. Poeti i gdhendjeve me fjalë të mrekullueshme, poeti i kontradiktave të mëdha arabe. Gjatë gjithë jetës së tij të mbushur me kontradikta, Nizar Kabbani krijoi një sërë krizash intelektuale dhe letrare. Ai është shprehës i vërtetë i kontradiktave të ligjërit arab në gjysmën e dytë të shekullit XX. Ai është poeti që shkatërroi me kurajë dhe guxim një sërë strukturash dhe mendësish tradicionale me të cilat

njerëzit ishin mësuar në të menduarit dhe traditat e tyre shoqërore. Poeti ynë ishte i lirë dhe rebel në atë që thoshte, për gjërat më të rëndësishme që preokuponin mendjen arabe dhe jo vetëm, si të menduarit, të vepruarit, dhe ndjesitë nga njëra anë dhe të gjitha gjërat e ndaluara të cilat konsideroheshin tabu dhe të liga deri atëherë nga ana tjetër. Çështja e gruas ishte diçka e parëndësishme deri atëherë, tabu deri diku, por shumë shpejt u kthye një çështje ku Nizari gjeti atë që donte, dhe e konsideroi si më të rëndësishmen në këtë ekzistencë! Në një prej poezive të tij ai u përgjigjet akuzave, të miqve, armiqve, poetëve dhe botës së asaj kohe:

Pse shkruaj për gruan

E gjithë bota më qorton...

Se për atdheun të shkruaj kam harruar...

Por për mua, atdheu nga gruaja fillon.

NIZARI DHE REVOLUCIONI I KONTRADIKTËS NË NDRYSHIM

Në mesin e shekullit të XX dhe pas Luftës së Dytë Botërore, u shfaq një elitë e mrekullueshme arabe poetësh, artistësh dhe intelektualësh që ishin të zënë me politikën,

ideologjitë revolucionare, nacionaliste, luftën, demokracinë dhe socializmin. Ama këtu Nizari nuk e shihte veten në asnjë rol të rëndësishëm. Gruaja ishte shqetësimi i tij kryesor, ai ishte fantastik në përshkrimin e saj, duke e imagjinuar atë ashtu siç donte mendja dhe imagjinata e tij. Ai përshkruante pamjet e belit, këmbëve, ecjes, gjoksit, thonjve dhe fijeve të flokëve të saj, të cilat ai i krijoi dhe i mishëroi në mënyrë ekspresive. Ishte brilant në përdorimin e fjalëve shumë të thjeshta në fjalimin e tij poetik që hynin drejtpërdrejt në shpirt pa asnjë ndërlikim dhe ia doli të përfshinte fjalë të zakonshme, të përditshme që njerëzit përdorin në mëngjes dhe në mbrëmje në Një mesin e shekullit të XX dhe pas Luftës së Dytë Botërore, u shfaq një elitë e mrekullueshme arabe poetësh, artistësh dhe intelektualësh që ishin të zënë me politikën, ideologjitë revolucionare, nacionaliste, luftën, demokracinë dhe socializmin. Ama këtu Nizari nuk e shihte veten në asnjë rol të rëndësishëm. Gruaja ishte shqetësimi i tij kryesor, ai ishte fantastik në përshkrimin e saj, duke e imagjinuar atë ashtu siç donte mendja dhe imag-

jinata e tij. Ai përshkruante pamjet e belit, këmbëve, ecjes, gjoksit, thonjve dhe fijeve të flokëve të saj, të cilat ai i krijoi dhe i mishëroi në mënyrë ekspresive. Ishte brilant në përdorimin e fjalëve shumë të thjeshta në fjalimin e tij poetik që hynin drejtpërdrejt në shpirt pa asnjë ndërlikim dhe ia doli të përfshinte fjalë të zakonshme, të përditshme që njerëzit përdorin në mëngjes dhe në mbrëmje në vjershërimet e tij. Dhe mund të them se Nizari shquhet për fjalorin e tij poetik dhe shprehjet që e veçojnë nga të tjerët. Ai mbeti njëkohësisht njeriu që e ruajti metrin poetik dhe u dashurua me muzikalitetin e disa fjalëve dhe shprehjeve, që ngjallte ndjenja dhe emocione të nxehta. Ai gjeti një mjedis shoqëror arab të shtypur deri në thelb, të ndrojtur e që nuk i jepte mundësinë të luante lojërat emocionale me gjithë guximin e tij. Rrethanat e asaj kohe e ndihmuan atë të përdorte të gjitha shprehjet për seksin, dashurinë, trupin dhe dëshirat. Por shpesh u detyrua të ndryshojë një numër të madh të fjalëve dhe shprehjeve të tij në njëzet vitet e fundit për shkak të ndryshimit të plotë të rrethanave në shoqërinë arabe, së pari, dhe

për shkak të humbjes së Belkisës, Kabbanite ngriti gruan me delikatesë, si një flutur që pëshpërit:

KABBANI POETI I GRUAS

Në botën arabe, kur përmendet emri i Kabbanit menjëherë të vete mendja tek çështja e grave, tek ligjërimi për to, tek lufta për t'i dhënë asaj vendin e duhur. Pra, e thënë ndryshe Nizari njihet si "Poeti i gruas". Poezia e tij vjen si reagim ndaj ndodhive, fenomeneve e ngjarjeve që ndodhën në familjen e tij dhe jo vetëm. Ai ishte dëshmitar i vetëvrasje së motrës së tij, Hadba, pasi ajo nuk donte të martohej me burrin që i kishte zgjedhur familja për bashkëshort. Një numër i madh librash kanë në qendër pikërisht këtë luftë, ku mund të përmendim: "Kështu e shkruaj historinë e grave", Ti je e imja, E dashura ime, Ditari i një gruaje indiferente, 100 letra dashurie. Një poemë për Belkisën, U martova me ty, liri, Dëshmoj që s'ka tjetër grua veç teje, Unë jam vetëm një burrë, ti je një fis me gra, Pesëdhjetë vjet në lavdërimin e grave... etj. Nizari nuk e prezantoi gruan si çdo qenie tjetër njerëzore, përkundrazi e shfaqti atë në një kornizë të bukur dhe nuk ndali ta zbulonte me petka, ngjyra dhe t'i ftonte të tjerët tek ajo me të gjitha përsëkrimet e tij të mrekullueshme. Njeriu në vetvete, ka natyrë poetike për të cilën mendoj se askush nuk e kundërshkon. Sigurisht gjeniu është diçka komplet tjetër, kur e dëgjojnë njerëzit gëzohen dhe zemra u këndon, aq më tepër kur ai zotëron edhe aftësi të mrekullueshme në recitimin poetik që rrëmben zemrat! Kabani është i vetmi poet në botë që kur çdo grua i lexon fjalët e tij, thëniet dhe poezitë, ndjen se është ajo që flet nëpërmjet tij. Ja pra, pse Nizari mban titullin "Mbështetësi i grave", pse jetoi dhe vdiq duke mbrojtur gratë... A ishte ky për Nizarin, kompensimi për atë që motrës së tij iu privua? Vepra e Nizar

*Atëherë kur të thashë: "të dua"
E dija se po udhëhiqja një grusht
shteti ndaj rendit fisnor
Dhe që po rrihja kambanat e skandalit.*

*Unë doja ta merrja pushtetin në dorë
Që ti bëj pyjet me më shumë fletë
Detet ende më të kaltër,
Ti bëja më të lumtur fëmijët e pafajshëm.*

*Dëshiroja ti jap fund rendit barbar
Të vrisja të fundmin sundimtar...*

*Kur të dashurova, doja të thyeya
dyert e haremeve
Të shpëtoja gratë nga dhëmbët e meshkujve
Që ëndrrat e tyre të vallëzojnë të lumtura*

Si farat e murrizit të kuq...

*Kur të thashë: "të dua", e dija se po
shpik një alfabet të ri
Për një qytet që nuk ka dëshirë të
lexojë,
Që po recitoja poezitë e mija në një
sallë të zbratur
Që po ju servirja nektar, atyre që
nuk dinë as vlerën e sheqerit.*

*Kur vendosa të vrisja sundimtarin e
fundit
Dhe të shpallja mbretërinë e dashurisë*

*Të mendoja ty si mbretëreshë.
Ndonëse e dija që vetëm zogjtë
Do ta mbështesnin revolucionin
tim.*

(Letra e 3-të, nga libri 100 letra dashurie)

Ende në moshë të re, kur ishte student i Fakultetit të Drejtësisë në Damask, ai do ta bënte për vete lexuesin e tij me librin e parë: "Më tha zeshkania" i cili u butua në vitin 1944, për tu pasuar më

pas me dhjetëra të tjerë njëri më i qëlluar se tjetri. Ai ishte i rrallë në formulimin e fjalëve, me lojën që bënte me to, me mënyrën sesi e përsëkronte vendlindjen, prindërit, familjen, shtëpinë... Kur flet për shtëpinë... "A e dini se çfarë do të thotë të jetosh në një shishe parfumi? Shtëpia jonë ishte e tillë. Nuk po mundohem t'iu manipuloj me një analogji të rreme, por besomëni, që me këtë analogji nuk i bie më qafë shishes së parfumit. Përkundrazi, parfumi është ai që i bie më qafë dhe errëson shtëpinë tone". Ndërsa kur flet për qytetin e tij të lindjes thotë: "Ata që kanë jetuar në Damask, që kanë hyrë në lagjet dhe rrugicat e ngushta të tij, e dinë se si ua hap krahët para jua, andej nga nuk e presin..." Përdashurinë e nënës së tij: "Njëzet fletë lulesh në oborrin e shtëpisë janë e gjithë pasuria e nënës sime. Secilën lule e do si një nga fëmijët e saj, ndaj sa herë harronim dhe i vidhnim një fëmijë, ajo qante dhe i ankohej Zotit për ne". Kujtimet e fëmijërisë: "Tani, pas tridhjetë vjetësh, mund t'i mbyll sytë dhe të kujtoj babain tim të ulur në oborrin e shtëpisë dhe përballë tij është filxhani i kafesë, dorezat, një kuti duhani dhe gazeta e tij. Në faqet e gazetës një lule jasmine e bardhë bie çdo pesë minuta, si të ish letër dashurie që vjen nga qielli. ...Nëse pengohesha, pengohesha në krahun e një pëllumbi dhe nëse rrëzohesha, bija në prehrin e një trëndafili". Për Kabbanin, poeti është njeriu i tërhequr, që bën një jetë askete, mistike dhe flituese në shërbim të poezisë. Dhe nëse gjysma e shkrimtarëve të botës të kenë mbaruar akademinë e kafesë, unë nuk do të isha nga të diplomuarit e kësaj akademie. Unë besoj se një vepër letrare është një akt adhurimi, që ka ritualet, ceremonitë dhe pastërtinë e saj, ndaj e kisha të vështirë të

kuptoja se si mund të dilte letërsia serioze nga grepi i nargjileve dhe nga kërcitja e zareve. Sigurisht, Nizari vdiq si të gjithë, ama trashëgimia e tij letrare do të mbetet, krahas historisë së tij letrare dhe intelektuale gjatë gjithë historisë së botës. Poezitë e tij patriotike, këngët e tij nacionaliste, qëndrimet e tij kritike dhe sarkastike dhe në shumë nga artikujt e tij që botoi vitet e fundit në faqet e gazetës së njohur Al-Hayat, ishte shembulli i një intelektuali që edonte jo vetëm gruan, por edhe tokën e atdheun e tij. Këngëtarët më në zë të botës arabe kënduan një sërë poezish të tij, duke përfshirë: Umm Kulthum, Najat, Abdel Halim, Fayza, Fairouz, Kazem, Majda, Asala... etj. Nizari përjetoi disa tronditje të forta në jetën e tij private, duke përfshirë largimin e nënës së tij ndërsa ishte fëmija i saj i llastuar, vdekjen e motrës së tij Visal nga sëmundjet e zembrës dhe vetëvrasja e motrës së tij Hadba. Gjithashtu u trondit nga vdekja e djalit të tij të vogël, Teufikut, gruas së tij të parë Zahrës pas një sëmundjeje, nga vdekja e gruas së tij të dytë, Belkisës, pas një shpërthimi në ambasadën irakiane në Bejrut, ku ajo punonte. Vitet e fundit të jetës së tij ishin një rrëmujë betejash, polemikash dhe poemash të nxehta politike, veçanërisht në vitet nëntëdhjetë të shekullit të kaluar. Ai la pas një det krijimtarie, një mori gjetjesh, fjalësh që vetëm Kabani mund t'i çonte ndërmend... Nuk ka dyshim, ai arriti ta përmbushë më së miri misionin e tij, duke e ngritur figurën e gruas në piedestale që nuk kish mundur ta bëjë asnjë poet përpara tij. Vdiq në Londër më 30 prill 1998 dhe u varros në Damask. Ai la pas veprat dhe poezitë e tij që njerëzit t'i ndjenin, këndonin ose t'i recitonin. Kabani na la një hambar perlash, librash, lirikash dhe stolish artistike, bashkë me të vdiq edhe legjenda e tij.



NUMRI I ARDHSHËM MË 15 PRILL

HEJZA

30 Mars, 2024

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:
Jeta Rexhepi - Shala & Rexhepi

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000